



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.7(456)

KORRIK 2026

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

10 KORRIKU

**NGJARJE
KULMORE
NË
HISTORINË
E LANÇ**



Gjeneral RRAHMAN PARLLAKU

FAQE 2

PERSONALITETE HISTORIKE

**UKSHIN HOTI,
MENDIMTARI
QË JETOI
PËRTEJ KOHËS
SË TIJ**




Rajmonda Maleçka

FAQE 11

84-VJETORI I DITELINDJES

**ËSHTË FAT
NË JETË TË
KESH MIK
PROF. HAJRI
SHEHUN**



Dr.Hasan DOMI

FAQE 5

BILANCI/ Aktualisht OBVLP ka degët e saj në 12 qarqet e vendit, me struktura efektive progresiste

32 VJET OBVLP, NË MBROJTJE TË VLERAVE TË LIRISË

BILANCI

HISTORI SUKSESI

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 32 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë.

FAQE 3

NDERIMI

DITËT NAIMIANE NË PËRMET E FRASHËR

Muharem Kamani

FAQE 7

RECENSA

ARTI I TË SHKRUARIT NË KRITIKAT LETRARE TË SHPENDI TOPOLLAJT

FATMIR MINGULI

FAQE 15



Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh*

• Në Kuvendin e fundit (26 korrik 2024) OBVLP, zgjodhi kryetare Znj. TATJANA PARLLAKU -ÇARKAXHIU, e cila, me qëndrimet publike në disa akademi përkujtimore, si dhe në disa veprimtari promovuese të librave të autorëve, anëtarë të OB VLP, me artikulumet brilante në vlerësim të LANÇ e të historisë së organizatës tonë, ka fituar jo vetëm respektin, por edhe autoritetin e duhur në masën e gjerë të veteranëve e pasardhësve si dhe në mjediset akademike, shkencore e letrare

FAQE 3

PROMOVIMI

TATJANA PARLLAKU: KOLONEL BESHIR CALA I ORIENTUAR DREJT VLERAVE EUROATLANTIKE



Dhjetra personalitete akademike dhe të letrave vlerësojnë librin e ish - drejtuesit të institucioneve kryesore kulturore të Ushtrisë Shqiptare

FAQE 8 - 9

PERSONAZH

HAXHI RRUSTË KABASHI, DËSHMOR I ATDHEUT

Nga Prof. Xhemal MEÇI

FAQE 6

PORTRET

FEIM ZENELI - PIONIERI I LUFTËS QË U BË USHTARAK I SHQUAR

Prof. asoc. dr. BERNARD ZOTAJ

FAQE 4

IN MEMORIAM

VILHELME VRANARI HAXHIRAJ, MISIONARE E DIJES DHE ATDHETARIZMIT

Avdyll Buçpapaj

FAQE 14

PROFILI

HYSEN SHEHU GJENERALI SHQUAR DHE KLERIK I LARTË SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI;

Dr. në proces Robert SHEHU

FAQE 10

REFLEKSIONE

VLERAT SHËRUESE TË RAZMËS

Leopold Loro Shkreli

FAQE 12

10 KORRIKU

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish-Jugosllavisë

NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ

RRAHMAN PARLLAKU

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësite guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut.

Po në korrik të atij viti, filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës së përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste.

Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësiteve që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësiteve taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, 75 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqendruar të Ushtrisë. Gjykoj se kjo datë do të zërë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë.

Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i pajisur me kulturë ushtarake.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative, që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës së kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëhershme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat territoriale, që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliuara, qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj.. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësiteve e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte mëse e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlikueshëm e drejtimit mungonin, kryesisht, komu-

Foto LSA



nikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgatiti e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinës ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj.. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhëniet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgatitja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thosha mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-'44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm, që e befasoi keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësiteve të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në

hapësira të mëdha të territorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore. Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësiteve që ishin të karakterit operativ-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqendroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të Kryeministrit, të ministrit të Jashtëm etj.. Por siç dihet, ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgatitura, si dhe komandat e njësiteve e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44, duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimit e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj, Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish-Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI, për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të pasur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu, u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kundër Aleatëve. Në këtë aspekt, është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish-Jugosllavi, për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

**Ish Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit*

BILANCI

Aktualisht OBVLP ka degët e saj në 12 qarqet e vendit, me struktura efektive progresiste

32 VJET OBVLP, NË MBROJTJE TË VLERAVE TË LIRISË

Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh*

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe pasardhësve (OBVLP), më 18 korrik 2026 mbush 32 vjet nga krijimi i saj. Në më shumë se tri dekada aktivitet intensiv, OBVLP u dëshmuua para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare.

64 PERSONALITETE, ISH-DREJTUES TË LANÇ, TË USHTRISË SHQIPTARE E STRUKTURAVE TJERA QEVERITARE, NISMËTARË TË KRIJIMIT TË OBVLP

Rënia e Murit të Berlinit në nëntor 1989 dhe ndryshimet demokratike në Evropën Lindore u reflektuan edhe në Shqipëri me përmbyshjen e diktaturës komuniste, duke sjellë ndryshimin e sistemit shoqëror dhe kalimin në demokracinë e bazuar në pluralizmin partiak dhe sigurimin e lirisë së njeriut.

Por, drejtuesit e shtetit të ri mbetën politikanët me prejardhje nga diktatura komuniste, më e egra në Evropën Lindore dhe rrjedhimisht qeverisja e re nuk mund të ishte plotësisht demokratike. Në këto kushte veteranët e luftës që nuk kishin marrë pjesë në krimet e PPSH dhe Enver Hoxhës, u mblodhën para 32 viteve (korrik 1994) dhe krijuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), që kishte për qëllim të mbështeste proceset demokratike dhe shtetin ligjor dhe t'i bashkonte veteranët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar në një organizatë të vetme, për të ruajtur më mirë traditat e luftës dhe të drejtat e tyre.

Kësisoj, e krijuar para 32 vitesh me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) do të bëhej promotore e mbrojtjes së vlerave tona kombëtare. Në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, mnistra e zv/ministra, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, gjeneral Nexhip Vinçani; Sadik Bekteshi (gjeneral lejtant - Hero i Popullit), gjeneral Muhamet Prodan, Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo, dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL) është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit diktatorial të E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamërituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë e LANÇ.

ORGANIZIMI

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrefeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon: Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar Z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Muharrem Bushati, Lushnjë me kryetar z.Iliaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Neziri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Jorgji Terca (Tiranë), Xhemal Meçi (Pukë), Agim Dylgjeri(Elbasan), Ali Demushi(Shkodër) etj.Në Kuvendin e fundit (26 korrik 2024) OBVL, zgjodhi kryetare Znj. TATJANA PARLLAKU -ÇARKAXHIU, e cila, me qëndrimet publike në akademitë përkujtimore

- Në Kuvendin e fundit (26 korrik 2024) OBVLP, zgjodhi kryetare Znj. TATJANA PARLLAKU -ÇARKAXHIU, e cila, me qëndrimet publike në disa akademi përkujtimore, si dhe në disa veprimtari promovuese të librave të autorëve, anëtarë të OB VLP, me artikulumet brilante në vlerësim të LANÇ e të historisë së organizatës tonë, ka fituar jo vetëm respektin, por edhe autoritetin e duhur në masën e gjerë të veteranëve e pasardhësve si dhe në mjediset akademike, shkencore e letrare

kushtuar gjeneralit legjendë Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, gjeneral Dali Ndreut - Nderi i Kombit, legjendës së aviacionit shqiptar Edip Ohri, si dhe në disa veprimtari promovuese të librave të autorëve, anëtarë të OBVLP, si Halil Rama, Skënder Murrja, Arben Alliu e Beshir Cala, me artikulumet brilante në vlerësim të LANÇ e të historisë së organizatës tonë, ka fituar jo vetëm respektin, por edhe autoritetin e duhur në masën e gjerë të veteranëve e paasrdhësve si dhe në mjediset akademike e letrare. Po ashtu, ky Kuvend bëri një ndryshim në Statutin e OBVL, duke e quajtur: Organizata e Bashkuar e veteranëve të LANÇ dhe paasrdhësve (OBVLP).

Aktualisht OBVLP ka degët e saj në 12 qarqet e vendit, me struktura efektive progresiste. Tre vitet e fundit OBVLP ka riorganizuar degët e saj në qarqet kryesore, si Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër e Dibër, në drejtimin e të cilave janë zgjedhur personalitete të njohura publike, si ish – oficeri shembullor HASAN SHEHU (Tiranë); publicist dhe shkrimtari i mirënjohur SHPENDI TOPOLLAJ (Durrës), studjuesi ALI DEMUSHI me karrierë të gjatë si officer shembullor (Shkodër); MAKSIM VINÇANI (Elbasan), MUHAREM KAMANI (Përmet); mësuesi veteran, shkrimtari dhe publicist Mevlud Buci (Dibër) etj.

KATËR PERSONALITETE TË OBVL-SË “NDERI I KOMBIT”

Pikërisht për rolin që ka luajtur, si mbrojtëse dhe promovuese e vlerave më të mira kombëtare shqiptare, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës për Liri e Pavarësi të Popullit Shqiptar (OBVL) është ndër organizatat më të vlerësuara nga institucionet shtetërore, me katër personalitete “Nderi i Kombit”. Me këtë titull të lartë të akorduar nga ish-presidentët Nishani e Meta janë vlerësuar dy kryetarët e parë të OBVL: Dr. Ymer Dishnica e gjeneral Rrahman Parllaku, si dhe gjeneralët Nexhip Vinçani e Veli Dedi.

Ish – kryetari i OBVL, gjeneral Rrahman Parllaku, është dekoruar me titullin “SIMBOLI I QYTETIT TË TIRANËS”, si dhe me titullin “QYTETAR NDERI” i Qarkut Kukës, “Qytetar Nderi” i Bashkisë Shijak dhe i ish - komunës Kurvelesh.

Ndërkohë, me “Dekoratën e Artë të Shqiponjës” janë dekoruar ish-themeluesit dhe drejtuesit ndër vite të kësaj organizate: Ish-nënkryetari dhe kryetari i saj, kolonel Myfit Guxholli, ish-sekretari i Përgjithshëm Edip Ohri dhe anëtarët e kryesisë: Liri Belishova e Hamit Keçi. Po ashtu, me propozimin e OBVLP ju është akorduar “Dekorata e Artë e Shqiponjës” komandantit të Çetës së parë Partizane të Gollobordës, patriotit të madh me rrezatim mbarëkombëtar Ahmet Cami, si dhe ish-kuadrit të Brigadës së 18, Ismail Bara.

Në 10 vitet e fundit janë dekoruar me titullin “Mjeshtër i Madh” drejtuesit aktualë të OBVL: Sekretari i Përgjithshëm, akademik Halil Rama, nënkryetari Muharrem Gjoka dhe kryetari i Degës së OBVL Pukë, studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Xhemal Meçi.

TRI RRUGË NË TIRANË ME EMRAT E PERSONALITETEVE TË OBVL

Gjerdanit të artë të vlerësimeve për personalitetet e OBVL-së iu shtua dy vitet e fundit edhe emërtimi i tri rrugëve të Tiranës me emrat e gjeneral Rrahman Parllakut, Liri Belishovës dhe Edip Ohrit. Kështu, në konsiderim të propozimit të Kryesisë së OBVL, Këshilli i Bashkisë Tiranë, me Vendimin nr. 55, datë 1.6.2020 ka vendosur që rruga te Tregu Agroushqimor (pranë shkollës jopublike “Sarina” të emërtohet Rruga “Edip Ohri”, ndërsa me vendimin nr. 137, datë 05.10.2020 ka vendosur që segmenti rrugor që bashkon rrugën “Ali Demi” me rrugën “Petro Nini Luarasi” të emërtohet rruga “Gjeneral Rrahman Parllaku”, si dhe rruga që nis nga rreth rrotullimi i “Astir”-it të emërtohet rruga “Liri Belishova”.

Kësisoj, përjetësohen tre personalitete të organiza-



tës tonë, me kontribute madhore gjatë Luftës së Dytë Botërore, në krijimin dhe konsolidimin e Ushtrisë e të Shtetit Shqiptar si dhe për themelimin e drejtimin me përkushtim të rrallë të OBVL-së.

ANËTARË E FEDERATAVE EUROPIANE DHE BOTËRORE TË VETERANËVE

Me një aktivitet intensiv në mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave, dr. Dishnica dhe gjeneral Parllaku arritën ta bëjnë OBVL-në anëtarë të Federatave Evropiane dhe Botërore të Veteranëve. Me pjesëmarrjen në aktivitetet e këtyre Federatave, jo vetëm në Evropë, por edhe në Malajzi, në Johannesburg, Marok etj, OBVL-ja ka bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II-të Botërore dhe në luftërat për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që jep sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s. Nisur nga ky aktivitet intensiv dhe vlerat që mbron e promovon, OBVL vlerësohet për orientim e drejtë, për veprimtarinë e gjallë të saj, për vetëdijen dhe besimin e veteranëve dhe pasardhësve, anëtarë të organizatës, jo vetëm në luftë, por edhe në demokraci.

OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 32 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë.

Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVLsë.

Në këtë 32-vjetor OBVL vjen e konsoliduar, e bashkuar dhe me energji e vendosmëri për të lëvruar më tej, pasuruar më shumë historinë reale të LANÇ dhe për të dhënë kontributin e saj real për konsolidimin e demokracisë e të shtetit ligjor, për një Shqipëri anëtare e denjë e NATO-s që ecën vendosmërisht drejt anëtarësim-it në Bashkimin Europian.

***Sekretar i Përgjithshëm i OBVL**

82 VJETORI I RËNIES

NJË TUFË ME LULE PËR DËSHMORIN FERIT RUSTEM HYMETLLARI

Në 82-vjetorin e rënies së dëshmorit Ferit Rustem Hymetllari, familjarë, të afërm dhe anëtarë të Organizatës së Dëshmorëve, Dega Pogradec, vendosën një tufë me lule pranë varrit të tij në Varrezat e Dëshmorëve të Pogradecit.

Ishte një ceremoni e thjeshtë, por me një domethënie të veçantë. Familja Hymetllari kishte zgjedhur të përkujtonte 15 qershorin e vitit 1944, ditën kur Feriti ra dëshmor për Atdheun. Në këtë përvjetor u sollën në kujtesë jo vetëm heroizmi i tij, por edhe sakrificat e mëdha të familjes gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Përfaqësuesi i familjes, Fetah Hymetllari, e vlerësoi këtë nismë si një mënyrë të denjë për të nderuar kujtimin e dëshmorit dhe për të rikujtuar kontributin e prindërve të tij, të cilët vunë gjithçka në shërbim të Atdheut, deri edhe gjakun e djalit të tyre.

Kryetari i Organizatës së Dëshmorëve të Pogradecit, Eqbert Çami, theksoi rëndësinë që ka përkujtimi i ditës së rënies së dëshmorëve, si dhe përkushtimin e vazhdueshëm të familjes Hymetllari për ruajtjen e kujtimin të Feritit. Sipas tij, kjo përvojë e vyer duhet të përhëndet dhe të shërbejë si shembull, në mënyrë që gjatë gjithë vitit të përkujtohen ditëlindjet dhe ditët e rënies së çdo dëshmorit.

Ndërsa prof. Bernard Zotaj, nënk-

ryetar i Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut, vuri në dukje se sakrificat e familjes Hymetllari është bërë pjesë e pandarë e historisë së lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ai theksoi se rruga luftarake e Feritit ishte e shkurtër në kohë, por e pasur në heroizëm. Më 15 qershor 1944, gjatë luftimeve të ashpra të zhvilluara në fshatin Kreshisht të Korçës, Ferit Rustem Hymetllari ra heroikisht në përballje me forcat naziste gjermane. Ai ishte vetëm 21 vjeç.

Kujtimi i tij mbetet i gjallë edhe sot. Emrin e dëshmorit e mban shkolla 9-vjeçare e fshatit Alarup, ndërsa një lapidar i ngritur në qendër të fshatit përkujton atë dhe dëshmorët e tjerë të kësaj treve.

Një dëshmi prekëse e respektit dhe dashurisë së familjes për dëshmorin është ruajtja e emrit të tij ndër breza. Njërit prej pasardhësve të familjes iu vu emri Ferit, duke vijuar kështu një traditë të bukur shqiptare që mban gjallë kujtimin e të parëve dhe nderon sakrificat e tyre. Feriti, trashëgimtari i emrit të dëshmorit, krijoi familjen e tij dhe e mban me krenari e dinjitet këtë emër të nderuar.

Në familjen Hymetllari është ngritur edhe një kënd i veçantë kujtese kushtuar dëshmorit. Në të janë vendosur busti i tij, fotografi, dokumente, dëshmia e shpalljes dëshmor, Flamuri i Familjes së Dëshmorit të Atdheut, si



dhe botime e materiale që pasqyrojnë jetën, luftën dhe veprën e tij. Ky kënd kujtese është shndërruar në një vatër edukimi patriotik për brezat e rinj të familjes.

Në përfundim të ceremonisë, familjarët dhe anëtarët e Organizatës së Dëshmorëve vendosën lule pranë varrit të dëshmorit dhe mbajtën një minutë heshtje në nderim të veprës dhe sakrificës së tij. Të pranishmit u

përkulën me respekt përpara kujtimin të luftëtarit të ri që dha jetën për lirinë e vendit.

Pas ceremonisë përkujtimore, familjarët shtruan një koktej modest, ku u shkëmbyen mendime dhe sugjerime lidhur me ruajtjen, mirëmbajtjen dhe nderimin e vazhdueshëm të figurës së dëshmorit të Atdheut, si pjesë e trashëgimisë historike dhe patriotike që duhet tu përcillet brezave.

PORTRET

FEIM ZENELI - PIONIERI I LUFTËS QË U BË USHTARAK I SHQUAR

Prof. asoc. dr. BERNARD ZOTAJ

Mjeshtër i Madh

Feim Azbi Zeneli lindi në vitin 1924 në fshatin Ramicë, në një familje të thjeshtë, punëtore dhe me tradita të spikatura atdhetare. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën plotore në Vlorë. Fëmijërinë dhe rininë e hershme i kaloi duke ndihmuar familjen në punët bujqësore e blegtorale, duke u edukuar me dashurinë për punën, ndershmërinë dhe atdhedashurinë.

Që në moshë të re u përfshi në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Familja e tij ishte mbështetëse aktive e luftës kundër pushtuesve dhe Feimi u bë pjesë e çetës territoriale të fshatit Ramicë. Ai u aktivizua gjithashtu në Organizatën e Rinisë Antifashiste, duke ndihmuar në shpërndarjen e trakteve, propagandimin e luftës çlirimtare dhe mobilizimin e të rinjve në radhët e rezistencës.

Në vitin 1942 doli partizan. Fillimisht u rreshtua në Çetën Plakë të Vlorës dhe më pas në Çetën Zigur Lelo. Me krijimin e Brigadës V Sulmuese, një nga formacionet më të lavdishme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Feim Zeneli u bë pjesë e saj dhe mori pjesë në shumë luftime kundër forcave pushtuese nazifashiste. Në brigadë kreu me përgjegjësi detyrën e komandantit të togës deri në çlirimin e



vendit. Ai luftoi jo vetëm në Shqipëri, por mori pjesë edhe në operacionet luftarake në Kosovë dhe në territorin e ish-Jugosllavisë, deri në Vishegrad, duke kontribuar në fitoren e përbashkët kundër fashizmit.

Pas çlirimit të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, u kthye në atdhe dhe ishte ndër të parët djem të Smokthinës që vazhdoi studimet në shkollën e pionierëve të luftës Skënderbej. Më pas përfundoi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe vi-

joi specializimin e lartë ushtarak në Bashkimin Sovjetik në degën e artilerisë, duke fituar njohuri të thelluara profesionale.

Pas përfundimit të studimeve, u emërua në repartet e artilerisë së Ushtrisë Popullore. Shërbeu me përkushtim në shumë garnizone e reparte ushtarake të vendit, si në Gjirokastrë, Delvinë, Elbasan, Përmet, Durrës, Kukës, Tiranë dhe Vlorë. Kudo ku punoi, u dallua për disiplinën, profesionalizmin dhe aftësitë organizative.

Në vitin 1967 u transferua në Vlorë, ku iu besua organizimi dhe drejtimi i Forcave Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore të rrethit. Në këtë detyrë dha një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen dhe organizimin e strukturave mbrojtëse, duke punuar deri në daljen në pension. Ai mbante gradën ushtarake Major.

Feim Zeneli ishte një nga artilerët më të përgatitur të Ushtrisë Popullore Shqiptare. Në çdo detyrë që iu ngarkua shfaqti ndershmëri, përkushtim, patriotizëm dhe korrektësi ushtarake. Për meritat e fituara gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe gjatë shërbimit të gjatë ushtarak, u dekorua me urdhra, medalje dhe vlerësime të shumta.

Megjithëse detyrat e çuan në shumë qytete të vendit, ai mbeti gjithmonë i lidhur ngushtë me vendlindjen e tij, Ramicën. E vizitonte shpesh fshatin, ruante

marrëdhënie të afërta me bashkëfshatarët dhe tregonte interes të veçantë për historinë, traditat dhe njerëzit e trevës së Smokthinës. Shkroi artikuj dhe kujtime për ngjarjet e luftës, për dëshmorët dhe veteranët, duke dhënë një kontribut të vyer në ruajtjen e kujtesës historike.

Pas daljes në pension u aktivizua në Organizatën e Veteranëve të Vlorës, ku ishte ndër anëtarët më aktivë. Shkrimet e tij u botuan në gazetën Zëri i Vlorës, në shtypin ushtarak dhe në botime përkujtimore, ndër të cilat edhe seria e njohur Yje të Pashuar. Nëpërmjet tyre ai la dëshmi të çmuara për brezat që sakrifkuan për lirinë e vendit.

Në jetën familjare ishte bashkëshort dhe prind shembullor. Së bashku me bashkëshorten rriti dhe edukoi gjashtë fëmijë: djalin Albert dhe vajzat Natasha, Afërdita, Vala, Vera dhe Mimoza, duke u përcjellë vlerat e ndershmërisë, punës dhe dashurisë për atdheun.

Feim Azbi Zeneli ndërroi jetë më 8 nëntor 1986 në Vlorë. Ai u përcoll me nderime si veteran i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe si ushtarak me kontribute të shquara.

Kujtimi i tij mbetet i gjallë në familje, në Ramicë, në Vlorë dhe në historinë e ushtrisë shqiptare, si shembull i luftëtarit trim, oficerit të përkushtuar dhe qytetarit të ndershëm.

PROFILI

Në 84-vjetorin e ditëlindjes të një prej personaliteteve më të spikatur në fushën e gjuhësisë shqiptare

ËSHTË FAT NË JETË TË KESH MIK PROF. HAJRI SHEHUN

Dr. Hasan DOMI

Pranvera me bukurinë e saj çdo ditë e ka të këndshme, por kur qëndron, bashkëbisedon e ndan mendime me njerëz të mençur e pozitiv dita bëhet më mbresëlënëse. E tillë ishte ajo që pimë kafe me prof. Hajri Shehun. Ashtu i paqtë, i urtë, i thjeshtë, vjen me atë hapin e tij të ngadaltë por të sigurt për te kafja e "Ringut". Ky është vendi më i përshtatshëm për profesorin pasi aty pranë "Mozaikut", ka banesën.

Me 10 qershor mbushi 84 vjet. Si gjithmonë, me një çantë jo të vogël në dorë. Kështu e ka zakon profesor Hajriu, që librin nuk e heq nga dora e kur lëviz, ato e kanë vendin në çantë, gjithmonë i kujdesur për to. Duke parë kujdesin e profesorit për librat, me vjen në kujtesë Makiaveli, që, pasi vishej mirë i thoshte shërbëtorit: "Kam takim me njerëz të mëdhenj e të ditur". Meqënëse temat kryesore të diskutimit janë librat, ndonjërin prej tyre dua ta kem të pranishëm.

Një material për qelizën e kisha punuar prej ditësh dhe para se ta çoja për botim te revista "Zani i Naltë", konsultimi, me prof. Hajriun më dukej më se i arsyeshëm. Pasi e lexoi materialin, shprehu vlerësimin; këtë e ndiqja gjatë dhe pas leximit, pasi gjuha e trupit e sidomos, mimika e tij lexohej lehtë. "Materiali ka vlerë dhe meriton ta botojë Komiteti Mysliman në atë libër periodik. Gjithmonë shkruhen materiale të një niveli të lartë" thotë profesor Hajriu. Më duhet ta redaktoj, nëse ke kohë të mjaftueshme më thotë.


Për korrektim bisedoj me ndonjë mësues gjuhe i thashë.

-Jo, se e bëj për pak minuta, më thotë profesori ashtu me buzëqeshjen e tij karakteristike.

Profesor Hajriu lexon pa syze, pavarësisht viteve që ka mbi supë. Megjithëse isha munduar ti harmonizoj si duhet ajetet e Kur'anit me të dhënat më të reja shkencore, tani, ato ç'ka kisha hedhur në letër po kalonin proven, pasi prof. Hajriu e nje mirë këtë fushë: ka redaktuar e botuar libra të kësaj natyre në Komitetin Mysliman Shqiptar, Universitetin "Beder", etj.

Teksa ishte i përqëndruar mbi materialin në letër A4, e kujtoja atë gjatë viteve në Institutin e Gjuhësisë pranë Akademisë Shkencave, kur i bëja ndonjë vizitë në vitet tetëdhjetë, kur isha student.

Profesori gjithmonë është i disponueshëm për të biseduar dhe pyetur lidhur me gjuhën shqipe, të rejtat shkencore, librat, botimet. Këshillat e tij janë aq të vlefshme, por që duhen dëgjuar me vëmendje dhe kujdes maksimal. Ai flet qetë dhe gjithmonë me timbrin e zërit të tij të ëmbël, miqësor, e shoqëruar me buzëqeshjen karakteristike që i jep një nur të veçantë. Nëse gjatë bisedës nuk je i saktë për atë çka po flet ose mënyra si po e trajton nuk është e duhura, një reagim i lehtë dallohet në mimikën e tij, besoj, gjithkush e konstaton. E si edukator i sprovuar që është nderhyrjen e ka me art dhe ar-



gumenta bindëse.

Të kesh mik prof. Hajri Shehun është fat në jetë.

Por çfarë veprimtarie jetësore ka pasur ky njeri i ditur dhe i thjeshtë njëhe rësh.

Lindi në Vleshë më 10 qershor të vitit 1942. Fshati i tij i lindjes, si dhe Zerqani historikisht janë konsideruar dy fshatrat me njerëzit më të shkolluar të rrethit të Dibrës. Në të tilla kushte u rrit dhe mbaroi arsimin e detyrueshëm. Pas mbarimit të shkollës pedagogjike me rezultate të shkëlqyera, vazhdoi studimet e larta në Institutin "Vastonçnëh Jazikov" në Moskë për orientalistikë. Në Universitetin Shtetëror të Tiranës u diplomua për gjuhë angleze - gjuhë shqipe. Njëherësh studioi edhe për pedagogji- psikologji (si degë e dytë) në vitet 1961-1965. Pas mbarimit të studimeve u emërua mësues i gjuhës angleze në gjimnazin e Peshkopisë. Kujtojmë se ishte viti 1965 dhe gjuha angleze ishte futur vetëm në qytete të mëdha, si Tirana, Shkodra, Korça etj. Kështu ishin të parët nxënësit e mësuesit të ri e të pasionuar Hajri Shehu, që po pajiseshin me anglishten sikurse bashkëmohatarët e tyre në qytetet kryesore të Shqipërisë të atyre viteve. Pas një viti, Seksioni i arsimit, Dibër e caktoi si mësues matematike në shkollën Fushë-Allie, por me kërkesë të Seksionit arsimit Gjirokaster transferohet në Shkollën "Asim Zeneli" si mësues i gjuhës angleze. Duke pare aftësitë e tij, jo vetëm si mësimdhënje por edhe si studiues pasionant (pasi i dhanë një leje krijuese disamujore) e emërojnë në sektorin e Leksikologjisë të Institutit të Gjuhësisë, i cili varej nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Përkushtimi i tij nga viti 1971 deri më 1993 dhe 1997 e deri në vitin 2010 është në Institutin e Gjuhësisë. Nga vitet 1993 deri në vitin 1995 ka qënë Pedagog në Universitetin e Ti-

ranës, në Katedrën e gjuhës angleze.

Hajri Shehu ka gradën shkencore doktor dhe titullin shkencor profesor. Veprimtaria shkencore madhe. Është bashkautor i "Fjalorit të Gjuhës së sotme shqipe", i vitit 1980, nderuar me Çmimin e Republikës; "Fjalorit të shqipes së sotme, Tiranë, 1984 (bashkautor); "Fjalorit shumëvëllimësh të gjuhës shqipe"(bashkautor për botim); "Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe", Tiranë, 2004; Fjalorit "Për pastërtinë e gjuhës shqipe", "Fjalor anglisht shqip" etj. Prof. Hajriu është bashkautor me djalin e tij, Bledarin te: "Fjalor anglisht-shqip i thënies dhe i njësive frazeologjike", "Fjalor xhepi anglisht-shqip" dhe "shqip-anglisht". Prof. Hajriut ka redaktuar Fjalorin arabisht-shqipe persisht-shqip, si dhe "Fjalor themelor i termave të bujqësisë", Tiranë 2006, "Fjalor i termave të artillerisë(shqip, anglisht-rusisht),"Fjalor i termave të prapavijës" (shqip-anglisht-rusisht), "Fjalor anglisht-shqip i fjalëve të urta" etj. Dashuria për Dibrën e ka shoqëruar gjithë jetën e tij. E kështu në studimet e tij hyn edhe "Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga Ujumuja"(qarku i Dibrës) në dorëshkrim dhe vëllimin e ii të këtij Fjalori. Në dorëshkrim ka edhe vepra të tjera.

Prof. Hajri Shehu është, gjithashtu, autor i disa monografive të botuara dhe disa në dorëshkrim dhe i më shumë se 100 artikujve shkencorë, që trajtojnë probleme të gjuhës së sotme letrare shqipe, si : "Rreth leksikut të prozës popullore tregimtare".

Vitet në Gjirokastër si mësues i gjuhës angleze e kanë nxitur që t'i kushtojë botimin "Për Gjirokastrën dhe nxënësit e Gjirokastrës"(memoristikë), botim i vitit 2019. Shumë artikuj shkencorë dhe recensa e oponenca shkencore janë rezultat i një pune të gjatë e plot pasion të autorit. Ai ka marrë pjesë

- Hajri Shehu ka gradën shkencore doktor dhe titullin shkencor profesor. madhe. Është bashkautor i "Fjalorit të Gjuhës së sotme shqipe", i vitit 1980, nderuar me Çmimin e Republikës; "Fjalorit të shqipes së sotme", Tiranë, 1984 (bashkautor); "Fjalorit shumëvëllimësh të gjuhës shqipe"(bashkautor për botim); "Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe", Tiranë, 2004; Fjalorit "Për pastërtinë e gjuhës shqipe", "Fjalorit anglisht-shqip" etj.

me kumtesa në konferenca e kongrese shkencore kombëtare e nderkombëtare si në Tiranë, Prishtinë, Ohër, Oxford, Teheran etj, si dhe në sesione shkencore në shumë rrethe të vendit.

Prof. Hajriu është anëtar i Shoqatës Europiane të Leksikografëve (Euralex) dhe i "Alex Nash Fellowship of Albanian Studies" në Universitetin e Londrës, ai është përfshirë në Librin Nderkombëtar të Biografive në Kembrixh, Britani. Profesor Hajri Shehu është studiues i palodhur. Por aq modest. Kur flet për njerëzit, kryesisht për bashkëpunëtorët e miqtë shumë të, ai thotë. Unë kam mësuar shumë prej tyre, por kam ende shumë për të mësuar. Ai ka shkruar me respekt për koleget e kolegët e tij në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, dhe në Institutin Albanologjik në Prishtinë, në katedrën e gjuhës shqipe, në Katedrën e gjuhës angleze, dhe në Katedrën e gjuhës ruse në Universitetin e Tiranës. Për bashkëpunëtorët dhe miqtë e tij të shumtë ka botuar librat. "Vise e vite dhe miq e shokë", 2025 dhe "Jetshkrime dhe vepra miqsh dhe shokësh të shquar", 2025. Pjesë e këtij libri të fundit pata fatin të jem edhe unë. E kam konsideruar nder e vlerësim të madh për punën time botuese shkencore.


Profesor Hajri Shehu ka ka botuar edhe tekste të gjuhës angleze për shkollat e mesme. Ka udhëhequr edhe disa diploma universitarësh e mastera pasuniversitarësh. Për probleme të gjuhës shqipe standarte ka botuar edhe shumë artikuj shkencorë -popullarizues në gazeta qendrore si "Mësuesi", "Shekulli", "Bashkimi", "Rilindja", "Drita islame", "Panorama", "Dita" etj, por edhe në gazeta lokale, si "Dibra", "Rruga e Arbrit", "Rrezja e Shkelzenit" etj.

Ai vijon të ketë vullnetin e studiuesit të palodhur. Urojmë përzemësisht të mos i mëjë vullneti dhe puna.

PERSONAZH

HAXHI RRUSTË KABASHI

(Dëshmor i Atdheut)



Rustem Kabashi u Lind më 1835 në lagjen Lushaj të Kabashit të Shënpalit të Pukës. Pas pushtimit të ushtrisë të Perandorisë Osmane u bënë rrënimet të mëdha. Abacia e Shënpalit u grabit dhe u rrënuar. Megjithatë rezistenca e malësorëve Pukas e Mirditas vazhdoi për afro 2 shekuj edhe pse malësorët u varfëruan duke humbur gjithçka veç

Lirisë. Prof. Rrok Zojzi thotë se kaq rrënim pësoi Dukagjini sa u bë shprehje "Me u ba Dukagjin për atë që rrënohej ekonomikisht" (U ba Dukagjin filanil)

(Monte di Dukagjin) - Malet e Dukagjinit - Pukë e Mirditë. Në këto rrethana Sulltan Sulejmani pranoi kushtet e Maleve të Dukagjinit: "Të qeveriseshin simbas Kanunit të Lekë Dukagjinit me krenët e veta tradicionale, të mos çarmatoseshin dhe të mos jepnin rekrut, por të pranonin organizimin në Bajraçe, duke ndihmuar ushtrinë turke kur sulmoheshin kufinj prej serbë e malazezë dhe të jepnin një taksë simbolike (2 grosh për shpi) si bindje ndaj Sulltanit. Kështu u rrit Rustem Kabashi me frymën e autonomisë, sado më varfëri. Duke kërkuar hapsirë e kushte jetese më të mira, shkoj tek Laçajt e Pukës, kushërinjt. Por edhe aty s'gjeti kushtet e duhura, prandaj emigroi në Prizren te Kabashët "vëllezërit". U mirëprit vëllezërisht tek lagjia "Ahmetaj", ku gjeti më shumë hapësirë. Duke parë se Lumi i Kabashit që zbriste nga mali afro 2 mijë m, mbi nivelin e Detit me ujë të bollshëm verë e dimër, mori lejen e fshatit dhe ndërtoi një mull bluje me ujë, kur filloi të vinin banorët e fushës për blujë, Pati aq sukses sa ndërtoi edhe mullin e dytë e të tretë. Kështu u bë ndër familjet më të pasura të Prizerenit. Me pasurinë e



Rruste Kabashi, Sulejman Vokshi

tij ndihmonte të varfërit e fatkeqët. Gjithashtu ngriti e organizoi Djelmninë e Kabashit si një forcë mbrojtëse ushtarake e politike.

Rrustë Kabashi i edukuar në Kabash të Pukës me frymën e autonomisë, gjë që e kërkoi edhe në Prizren me aq guxim e këmbëngulje, sa u bë një rrezik serioz për autoritetet osmane dhe veglat e tyre. Përpjekja për ta frenuar e "ba zap" hasi në kundërshtimim e mosbindje të Tij, sa filluan internimin e burgosjen e Tij, por pa sukses se ndërhynte Djalëria e Kabashit, e cila nuk qetësohej pa lirimin e Rustem Kabashit. Për ta larguar nga Prizreni i krijuan mundësinë që të shkonte dy herë në "Haxh", në Qabe, në Arabi. Por më kot se u bë më autoritar, sa bujqit katolikë të Gjakovës i kërkuan mbrojtje, kur disa pronarë u kërkuan të largoheshin prej tokave që punonin për jetesë. Nënë ato prona do të vëndosëshin familje myslimane që rrinin nga malësitë e varfëra të Shqipërisë veriore. Këto familje katolike të dëshpëruar në kulmë, se aty punonin e jetonin që prej 3-4 brezash. Të dëshpëruar iu dre-

jtuan Haxhi Rrustë Kabashit në Prizren që t'i merrte në mbrojtje e t'i shpëtonte nga përzënia prej Gjakove. Haxhi Rrusta që aq shumë e çmonte lirinë e drejtësinë, shkoi në Gjakovë, ku shpalli vendosmërinë e Tij se nuk lejonte përçarje fetare myslimanë e të krishterë. Për këtë paralajmëroi pronarët e tokave si dhe qeveritarët vendorë e bujqit se ishin "ndorja" e tyre bashkë me Djelmninë e Kabashit. Këtë mbrojtje të Haxhi Rrustë Kabashit e tregonin me mirënjohje e plot respekt, siç na e shprehin një prej familjes (Radi, kushërinjë të Francesk Radit). Bile na tregoi se ky fakt prej Atdhetari ia kishin treguar në një kishë katolike (në përendim të Stambollit, treguar në një pllakë në muret e asaj kishë) në Traki të Stambollit.

Këtë akt respekti për katolikët e Gjakovës ia uroi edhe Sulejman Vokshi, ushëheqsi ushtarak i vullnetarëve mbrojtës të L.Sh.P. Ndihma e Rrustë Kabashit me djelmninë e Kabashit ishte kaq e madhe, sa e tregojnë vargjet e këngës kushtuar L.Sh.P "Sulejmani hypi n'thep, bash si zana po pisket": Bini ju Kabash, hej burra!...

Rrust Kabashi nuk u pajtua asnjëherë me denimin e udhëheqjes së L.Sh.P. sa më 1865 filloi një kryengritje e cila u hap edhe në Lumë deri në Pukë me Mustafë Agë Kryeziu, sa sulltani nxori amnistinë, duke i liruar Krenët L.Sh.P.

Më 1912 kur Shefqet Turgut Pasha kërkoi zbatimin e reformave të "Turqve të rinj" Rrustë Kabashi kundërshtoi me aq vendosmëri sa e denuan me varje në litar, por Rrustë Kabashi: "Thirri: Ma mirë në litar se tradhëtar".

Një mesazh Atdhetar ky.

Rustem Rexhep Kabashi, patriot, atdhetar, zemëzjarrtë, sikurse njihet Robin Hudi Shqiptar janë përgatitur dokumentat për nisjen e procedurave ligjore.

Ky ka qene një prijës e luftëtar mitik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryengritës i gjithë epokave, prijës i kryengritjeve të mëdha shqiptare të 1909-1910-ës, në prag të Pavarësisë shqiptare, babai i 14 djemve dhe 5 vajzave, katër herë i burgosur nga osmanët, katër herë i internuar dhe për mosbindje ndaj pushtuesit, i dënuar "me varje në litar" në qendër të Prizrenit, duke ngehur përjetësisht momoment atdhetarie dhe përjetësie për truallin arbëror.

DY FJALË PËR BOTIMIN E DYTË



Prof. Dr. Shefqet Hoxha

të varjes dhe u prit mire. Pas këtij aktiviteti pasardhësit e Rustem Kabashit. Gjurmova dhe munda të mbledh 50 dokumente dhe 15 këngë kushtuar Rustemit dhe kabashasve. U shtova edhe të dhëna historio-grafike dhe formtova një libër për heroinë e Kabashit, i cili që bërë gati në vitin 2014, por mbeti dorëshkrim. Në vitin 2022 "Mjeshtri i Madh", Xhe-

mal Meçi, shprehu dëshirën për të bashkëpunuar dhe shkroi "Hyrjen" dhe më solli disa materiale që unë nuk i posedoja. E falenderoj pa masë. I plotësuar tani, libri po botohet në shenjë nderimi për heroinë e Kabashit, të cilin disa studiues të siperfaqshëm e kanë akuzuar pa të drejtë. Ky hero është vlerësuar e dekoruar nga presidenti i Shqipërisë, zoti Sali Berisha me "Urdhërin për Veprimtari Patriotike Kl. I-rë". Por Rust Kabashi meriton më shumë. Është dëshmor, madje hero i kombit shqiptar.

I përjetshëm kujtimi i tij!


Tiranë, Prill 2022

Rustem Rexhep Kabashi, patriot, atdhetar, zemëzjarrtë, sikurse njihet **Robin Hudi Shqiptar** janë përgatitur dokumentat për nisjen e procedurave ligjore.



Prof. Dr. Bernard Zotaj Kryetar i Shoqatës së "Historianëve Ushtarakë"

Ky ka qene një prijës e luftëtar mitik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryengritës i gjithë epokave, prijës i kryengritjeve të mëdha shqiptare të 1909-1910-ës, në prag të Pavarësisë shqiptare, babai i 14 djemve dhe 5 vajzave, katër herë i burgosur nga osmanët, katër herë i internuar dhe për mosbindje ndaj pushtuesit, i dënuar "me varje në litar" në qendër të Prizrenit, duke ngehur përjetësisht momoment atdhetarie dhe përjetësie për truallin arbëror.



Para monumentit të dëshmorëve të UÇK-së Korish, Kabash, Prizeren 2010



Shefqet Hoxha, Rahman Parllaku, Bilbil Dervishi, Shaban Braha.



NDERIMI



Konferencë Shkencore në 180-vjetorin e lindjes së poetit kombëtar, Naim Frashëri

DITËT NAIMIANE NË PËRMET E FRASHËR

Muharem Kamani

Me rastin e 180 -vjetorit të lindjes të poetit kombëtar, Naim Frashëri, Shoqata atdhetare kulturore mbarëkombëtare "Vëllezërit Frashëri", në bashkëpunim me Bashkinë Përmet, Kryegjyshitën Botërore Bektashiane dhe SHAK "Tomorri" në Përmet dhe Frashër, organizuan poetekën dhe një Konferencë Shkencore. Veprimtaria u zhvillua mbasditen e 24 Majit 2026, në kinemanë "13 Shtatori" të Bashkisë Përmet, në praninë e dhjetra personaliteteve e poetëve kombëtarë e ndërkombëtarë, nxënës shkollash, qytetarë dhe dashamirës të poezisë.

Nderuan me pjesëmarrjen e tyre Kryegjyshi Botëror i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane Dede Baba Edmond Brahimaj, kryetarja e Bashkisë Përmet, Alma Hoxha, kryetarja e këshillit bashkiak Anila Ibrahim, nënprefekti i rrethit Përmet Edvin Tuçi, kryetari i KSHA "Naim Frashëri" Ligor Shyti, kryetari i SHAK Përmeti Kastriot Bezati etj.

Mbas ekzekutimit të Himnit Kombëtar, për të nderuar poetin kombëtar Naim Frashëri në 180-vjetorin e lindjes, aktori me famë botërore Xhevat Limani interpretoi poemën "Bagëti e bujqësi" të këtij poeti, duke emocionuar të pranishmit që e duartrokritën me ovacione të shumta. E moderuar arististikisht nga Kozeta Jashari, veprimtaria vijoi me përshëndetjen e kryetarit të SHAK "Vëllezërit Frashëri", Tomorri Kotorri i cili vlerësoi përmasat kombëtare të poetit Naim Frashëri, duke i dhënë vlera kombit shqiptar dhe duke u shndërruar në ëngjëjllor. Ai tha se në këtë atmosferë, poezia bëhet pishtar drite dhe na kujton amanetin e frashërlinjëve të shquar: "Ta duam, ta mbrojmë dhe ta lartësojmë Shqipërinë". Antologjia e botuar dhe prezantuar me këtë rast është një homazh për Naim Frashërin i cili na ndriçon mëndjet e na ngroh zemrat tona. Jep mesazhin e madh që vjen nga historia, dashuria për gjuhën, kulturën, kombin shqiptar dhe lirinë.

Përshëndeti më pas Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj, i cili e vlerësoi Naim Frashërin, jo vetëm si poet, por dhe si udhërrëfyesi shpirtëror i shqiptarëve.

Kryetarja e Bashkisë Përmet Alma Hoxha uroi pjesëmarrësit për mirëseardhjen në këtë aktivitet jubilar të 180

• Vlerësohen me titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Përmet, aktori me famë botërore Xhevat Limani dhe akademik prof. dr. Jeton Kelmendi, poeti shqiptar më i përkthyer në Europë e në disa vënde të botës në disa gjuhë



vjetorit të lindjes së Naim Frashërit. "Me përgatitjen e botimit të Antologjisë poetike: "100 poetë për Naim Frashërin", me poezitë e poetëve shqiptarë e të huaj, realizuam një projekt të përbashkët, duke e bërë më të plotë këtë përvjetor jubilar. Naim Frashëri dhe vëllezërit e tij ishin figura emblematike të kombit shqiptar. Ne përmetarët jemi krenarë. Vështirë të gesh një shqiptar që nuk njihet e di vargjet e Naimit, diellit të kombit i cili me vargjet e tij i dha dritë mendimit, shpirtit shqiptar e ndërgjegjes kombëtare në breza, aktuale dhe sot", tha kryebashkiakja Hoxha.

Aktorit Xhevat Limani ju dorëzua Titulli: "Qytetar Nderi" i Bashkisë Përmet, me Vendim Nr.49 dt.07.05.2026 të Këshillit Bashkiak. Jetëshkrimin dhe veprimtarinë e tij artistike e lexoi për pjesëmarrësit poeti përmetar Janaq Jano.

Me titullin: "Qytetar Nderi" i Bashkisë Përmet u nderua edhe Akademik prof. dr. Jeton Kelmendi nga Peja që punon në Prishtinë dhe Bruksel, titull të cilin ja dhanë Kryetaria e Bashkisë Alma Hoxha dhe e Këshillit Bashkiak Anila Mihali. Poeti Lumo Kolleshi, duke prezantuar jetëshkrimin e Prof. Kelmendit, ndër të tjera tha se ai është poeti shqiptar më i përkthyer në Europë e në disa vënde të botës në disa gjuhë.

Duke marrë titullin prof. Kelmendi shprehu kënaqësinë se ndihej shumë i privilegjuar dhe premtoi se do e mbaj me nder e krenari. "Qysh sot në ditëlindjen e madhe të Naimit, 180 vjetorin e lindjes së diellit për kombin shqiptar, jam qytetar i Përmetit. Ndihej i lidhur më shumë me ju e do t'u përfaqësoj kudo me nder e do u promovoj", tha prof. Jeton Kelmendi. Kozeta Jashari prezantoi poetët ndërkombëtarë që kanë sjellë poezitë e tyre në këtë festival: Costantino - Barbu Rumani, Dino Kubatis - Greqi, Corina Paralescu - Rumani, Julio Pavaneçi - Uruguaj, Athanas Vantcev De Thracy - Francë, Klaudia Piccinno - Itali, Dragan Mitic - Slloveni, etj.

Ndër ta, Dino Kubatis, duke përshëndetur poetekën me emocion: "Nder i madh që ndodhem sot në Shqipëri. Vij pas një kohe të gjatë, e dua Përmetin siç dua Shqipërinë. Ju falënderoj për këtë ngjarje poetike dhe për kënaqësinë që më dhuroar sot".

Akademik prof. dr. Jeton Kelmendi mbajti kumtesën me vlera studimore e prurje të reja të padëguara më parë për veprën letrare të Naim Frashërit e cila u dëgjua me shumë vëmendje nga pjesëmarrësit në veprimtarinë jubilarë.

Gazetari e shkrimtari Kujtim Boriçi foli si redaktor i përgatitjes për botim të kësaj Antologjie poetike.

Në këtë veprimtari mbresëlënëse recituan poezitë e botuara në antologjinë poetike poetët: Afërdita Selenica, Bekim Kelmendi, Odise Kote, Dashnor Male, Migena Arllati, Skënder Lazaj, Mimoza Osmani, Nurie Budini, Elmira Rama, F.Pajo, Agim Bajrami, Haxhi Kalluci, Lumo Kolleshi, Rakela Zoga, Lola Shehi, Janaq Jano, Arjola Kondakçi, Hysen Berisha, Jeton Kelmendi, Kujtim Mateli, Melisa Baboçi, Hamdi Hysuka, Xhelal Tosku, Corina Paralescu dhe Anila Mihali. Ditën e dytë të veprimtarisë më 25 Maj, u organizua pelegrinazh në Frashërin lavdimadh të historisë. Pjesëmarrësit, pasi u grumbulluan në oborrin e shtëpisë muze të vëllezërve frashërlinj, bënë homazhe pranë busteve të Vëllezërve Frashëri. Nxënësit e shkollave të Bashkisë Përmet dhanë një program artistik.

Në odën e miqëve të shtëpisë muze ku u mblodhën të ftuarit e ditës naimiane u bë qerasja tradicionale sipas traditës së krahinës së Dangëllisë.

NAIM FRASHËRI, POETI DHE FRYMËZUESIT I RILINDJES KOMBËTARE

Më 25 maj të vitit 1846, në Frashër të Dangëllisë, lindi Naim Frashëri, poeti dhe frymëzuesi i Rilindjes Kombëtare.

Naimi u formua me një botëkuptim të gjerë kulturor dhe filozofik, mes traditës orientale të vendlindjes dhe kulturës perëndimore në gjimnazin "Zosimea" të Janinës. Kjo përgatitje i dha mundësinë të sillte ide të reja për arsimin, letërsinë dhe përparimin e popullit të tij.

Si pjesëmarrës aktiv në Lidhjen e Prizrenit dhe në Shoqërinë e Stambollit, kontriboi në përhapjen e mësimin në gjuhën amtare dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë mes shqiptarëve.

Krijimtaria e tij letrare zë një vend të veçantë në kulturën tonë. Veprat e tij dallohen për gjuhën e pastër, ndjenjën njerëzore dhe frymën atdhetare që përcjellin.

"Ti Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqiptar" mbetet edhe sot një nga thirrjet më të fuqishme të dashurisë për vendin.

PROMOVIMI

Dhjetra personalitete akademike dhe të letrave vlerësojnë librin e ish - drejtuesit të institucioneve kryesore kulturore të Ushtrisë Shqiptare

TATJANA PARLLAKU: KOLONEL BESHIR CALA I ORIENTUAR DREJT VLERAVE EUROATLANTIKE

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Libri më i ri i autorit Beshir Cala, “Guri i shkullur”, ka bërë bashkë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, akademikë dhe miq të letrave në një promovim të mbushur me emocione, të organizuar nga OBVLP dhe Shtëpia Botuese “Univers”.

Siç vlerësoan personalitete të letrave, “Guri i shkullur” vjen si një reflektim i thellë mbi rrënjët, identitetin dhe peshën e vendlindjes. Përmes një stili të spikatur shkrimor dhe dokumentar, autori Cala që ka drejtuar për 40 vjet me talent, kompetencë dhe profesionalizëm institucionet më të rëndësishme kulturore të Ushtrisë Shqiptare (ish - Estradën e Ushtarit dhe Shtëpitë e Kulturës së Ushtrarakëve Tiranë, Durrës e Gjirokastrë) - sjell para lexuesit një meditim të ndjerë mbi fatin e njeriut përballë largimit nga trangu i tij. Kësaj, Cala ka gjetur një gjuhë mjaft universale për të prekur një plagë të hershme dhe aktuale. Me një mesazh të qartë dhe vlera të shtuara për poezinë shqiptare, “Guri i shkullur” tashmë ka nisur rrugëtimin e tij drejt lexuesit.

DOKUMENTARI...

Qindra pjesëmarrësit në promovimin e librit “GURI I SHKULLUR” të Beshir Calës, ndoqën në fillim të këtij eventi dokumentarin kushtuar këtij personaliteti të shquar të artit, kulturës e letrave.

Përveçse në fjalën artistike (sipas skenarit tim), profili jetësor dhe krijues i këtij shkrimtari dhe artisti, evidentohet në këtë dokumentar nga personalitete të njohura, si: Prof. dr. Bujar Kapexhiu - Nderi i Kombit, kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali – “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, Prof. dr. Petrit Bara – Zv/rektor dhe Dekan i Universitetit “Luarasi”, poeti dhe studiuesi Sakip Cami, aktori dhe gazetari Arben Mevlani dhe kryetari i Shoqatës së Pensionistëve të Shqipërisë Enver Hasa.

Kapexhiu, Zhulali dhe Mevlani, ndër të tjera flasin për kohën kur Beshir Cala drejtoi me kompetencë dhe profesionalizëm institucione të rëndësishme kulturore - artistike të Ushtrisë Shqiptare, Estradën e Ushtarit, si dhe Qendrat Kulturore të Ushtrisë Tiranë, Durrës e Gjirokastrë, ku shërbeu me përkushtim e talent të rrallë në harkun kohor të katër dekadave (1968-1998).

Duke e vlerësuar Beshirin, një njeri të veçantë, të përkushtuar, të drejtë, të fortë, që i shkonte për shtat edhe uniforma e ushtarakut, kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali, edhe sot e kujton zërin e tij të thellë, të plotë, herë i butë e herë i fortë, të qartë e me shumë emocione.

“Ndonëse me Beshirin kishim njohje të hershme si shok feminije i vëllait tim Safet Zhulalit, apo vëllai i kolegut tim Skënder Calës, në vitet 1993 -’94, komunikimi jonë njohu një stad tjetër. Së bashku, ai në rolin e drejtorit të SHQUP dhe unë të drejtimit artistik, morëm detyrën e krijimit të një grupi artistik në një koncept të ri dhe në frymën e shteteve perëndimore, anëtare të NATO-s. Ishte

me të vërtetë një sfidë pasi dëshira jonë ishte të ngremë një grup cilësor, ndërkohë që vështirësitë e kohës ishin të shumta. Megjithatë arritëm të krijojmë orkestrën me instrumentistët më të mirë të Shqipërisë, si Dashnor Hoxha - sax, Elton Deda - piano, Arjan Gjici - kitarë, Hektor Duri - bass etj; këngëtarët Adri-



ana Ceka, Redon Makashi si dhe aktorët Met Bega, Veli Rada, Behar Mera e një grup i vogël baleti... Natyrisht, të punojë me Beshirin ishte vërtet kënaqësi. Korrektesa, matura, zgjuarsia, thjeshtësia që e karakterizonin e bënë atë të ishte shumë i lidhur me punonjësit e të gëzonte, jo vetëm autoritet por edhe respekt të thellë njerëzor.

Beshiri i takon një brezi intelektualësh idealistë që besonin në drejtësi e demokraci e që nuk bënë kurrë kompromis me këto vlera. Ishin vitet e vështira ‘97, e një ditë i them Beshirit: kam frikë se ndoshta mund të të lëvizin nga detyra se shumë gjëra kanë ndryshuar... Jo, tha. Unë e kam mbrojtur në ditët më të vështira me jetën time këtë institucion... Buzëqeshja ime e bëri të ndryshojë, ndërsa iku pa folur... por më vonë më thonte: Mondit, kishe të drejtë. E kur takoheshim e pinim ndonjë kafe thonim, vërtet a ja vlen të jesh kaq i përkushtuar dhe i ndershëm në jetë?! ...Akoma nuk e kam marrë këtë përgjigje në fakt. Beshiri mbetet për mua një ndër miqtë e veçantë, një intelektual, zyrtar korrekt, shok i çmuar, prind i përkushtuar, e pse jo, edhe një njeri me vlera krijuese edhe në fushën e letërsisë e aktrimit, e mbi të gjitha, njeri”, shprehet Edmond Zhulali në dokumentarin që u shfaq në këtë event promovues mbresëlënës.

Aktori, regjisor i skenaristi i mirënjohur Bujar Kapexhiu, një nga bashkëpunëtorët, shokët e miqtë e tij më të afërt, e vlerëson Beshirin si më të diturin, më të pjekurin, më të përgjegjshmin, më të mirin si njeri e si artist, më të arsyeshmin, më të përkushtuarin dhe më të vendosurin në shërbim të ushtrisë, të shoqërisë, të atdheut..., devizë e tij kjo, paçka se pak e vlerësuar zyrtarisht...

Prof. dr. Petrit Bara – zv/rektor i

• Prof.dr. Bujar Kapexhiu - Nderi i Kombit, Prof. dr. Petrit Bara, Arben Mevlani e Sakip Cami, flasin në dokumentarin kushtuar Beshir Calës (pas vdekjes) ...

tim të grupeve të punës për probleme të ndryshme i ra Shqipërisë tej e mbanë.

Ndërsa Enver Hasa, ndër të tjera thekson se Beshir Cala ashtu siç ishte në jetë një intelektual erudit, ikonë e artit e kulturës kombëtare, krijoi dhe një familje solide. E mbi të gjitha ishte një atdhetar i flaktë, po pa rrahje gjoksi e protagonist; atdhetar në gen e konsekuent, si përfaqësues tipik i karakterit dibran. Veterani Enver Hasa, përfaqësues dinjtoz i Lumës në metropolin shqiptar, ndër të tjera pohon se ai, familja dhe fisi i tij emërdritur nga Vila e Kukësit, kanë qenë dhe janë në miqësi të pandarë me Beshirin dhe familjen Cala të Dardhës.

“GURI I SHKULLUR”, LIBËR AKTUAL EDHE PËR DITET TONA

Kryetarja e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, shprehu kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e drejtueses së kësaj organizate ishte pjesë e përfundimit të vëllimit poetik të autorit Beshir Cala, “Guri i Shkullur”. Duke folur për formimin e Beshirit si një atdhetar dhe intelektual i shquar ajo tha se “Patriotizmi dhe atdhedashuria u edukuan dhe u trashëguan nga familja e tij. Që në fëmijëri ai spikati për vlerat dhe formimin e tij, veçanërisht pas kthimit të familjes nga Tirana në Lugje të Zall-Dardhës, Dibër, kur ai vazhdoi shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi dhe, pas përfundimit të saj me rezultate të shkëlqyera, punoi si mësues i gjuhës dhe leximit letrar, duke edukuar te nxënësit e Zall-Dardhës dashurinë për atdheun, lirinë dhe gjuhën e bukur shqipe. Në këto vite filluan të shfaqeshin vlerat e tij krijuese dhe artistike, të cilat e shoqëruan edhe gjatë shërbimit ushtarak, ku u dallua për vullnetin në kryerjen e detyrës dhe përkushtimin në organizimin e veprimtarive të rëndësishme kulturore e artistike të ushtrisë. Kjo bëri që atij t’i jepej grada e oficerit dhe të emërohej nga Komanda si Përgjegjës Kulturë në Shtëpinë e Oficerëve të Durrësit, të cilën e transformoi brenda një periudhe të shkurtër në qendrën kulturore më të rëndësishme të ushtrisë shqiptare”.

Dashuria për arsimin dhe dijen triumfoi kur, në vitin 1971, Beshiri fitoi konkursin e Institutit të Lartë të Arteve, sot Universiteti i Arteve në Tiranë, të cilin e përfundoi me sukses në vitin 1975, duke u diplomuar si aktor.

Pas studimeve të larta, ai punoi si përgjegjës i Shtëpisë së Ushtrarakëve në Gjirokastrë, të cilën, përsëri, brenda një kohe të shkurtër, e shndërroi në një qendër të rëndësishme kulturore të

Universitetit “Luarasi” dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të këtij universiteti, si ish nxënës i Beshir Calës kujton vitet kur ai me talent, dashuri e profesionalizëm jepte lëndët gjuhë shqipe e lexim letrar në shkollën 8-vjeçare Zall Dardhë, si dhe miqësinë me të kur ai drejtonte Estradën e Ushtarit e SHQUP në Tiranë.

Ndërsa Sakip Cami, duke u ndalur në vlerat ideartistike të librit “Guri i shkullur”, ndër të tjera shprehet në këtë dokumentar: “Jo vetëm historia, por edhe bukuritë magjepsive të natyrës, të Korabit e të Drinit, të Setës e të kreshtave përreth, magjia e këngëve e të valleve të Dardhës ku kanë dalë njerëz të shquar të artit si Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Lirie Rasha, Skënder Cala, Xhelal Çerpja, Qerim Sula, Caje Polshi, Sherif Dervishi, e shumë të tjerë që tundën skenat e festivaleve folklorike kombëtare e deri ato ndërkombëtare, janë të gdhendura artistikisht në këtë libër”.

Arben Mevlani pohon se Kolonel Beshir Cala, me funksionin e drejtorit të Estadës së Ushtarit dhe të Qendrës Kulturore të Ushtrisë, kontribuonte me shumë përkushtim në organizimin në institucion e jashtë tij të shumë eventeve të kohës, - artistike, letrare, shkencore, shoqërore, ushtarake, atdhetare etj, - në ndihmë e shërbim të reformimit, riorganizimit, integritimit euroatlantik të ushtrisë në kushtet e rendit të ri politik - shoqëror... Në ato vite, siç shkruan kolonel Fuat Çeliku (në kapitullin “Beshir Cala në kujtimet e bashkëkohësve” të këtij libri), ai dha kontribut të jashtëzakonshëm për lartësimin kulturor e mental të ushtrisë në nivelin euroatlantik, që ajo të bëhej sa më shpejt anëtare e NATO-s, organizoi e përgatiti disa aktivitete të mëdha në nivel ushtrie e shtetëror, dhe në përbërje e drej-

PROMOVIMI

Dhjetra personalitete akademike dhe të letrave vlerësojnë librin e ish - drejtuesit të institucioneve kryesore kulturore të Ushtrisë Shqiptare

TATJANA PARLLAKU: KOLONEL BESHIR CALA I ORIENTUAR DREJT VLERAVE EUROATLANTIKE

Vijon nga faja 8

ushtrisë shqiptare. Më pas, ai u transferua në Tiranë si shef i veprimtarive kulturore dhe artistike. Këtu u dallua veçanërisht pranë Estradës së Ushtrisë, ku me karakterin e tij frymëzues dhe origjinal, si edhe me muzikalitetin e tij letrar, që buronte natyrshëm, i jepte vlerë e hijeshi çdo materiali artistik të përgatitur me shumë kujdes prej tij. Më vonë, ai shërbeu për shumë vite si drejtor i SHQUP-it, qendrës më të madhe kulturore dhe artistike të Ushtrisë Shqiptare. “Unë pata fatin ta njoh nga afër kur, në vitin 1994, ai u zgjodh Sekretar i Shoqatës Shqiptare të Atlantikut, me President zotin Alfred Moisiu, i cili më vonë do të bëhej President i Republikës së Shqipërisë. Në këtë detyrë, ai shpalosi vlerat e tij euroatlantike dhe perëndimore, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në veprimtari me karakter kombëtar në kuadër të NATO-s dhe më gjerë”, tha Znj. Parllaku. Ajo vlerësoi gjithashtu redaktorin e shquar, Mjeshtrin e Madh, Halil Rama, falë punës së palodhur të të cilit lexuesi ka mundësinë të njohë poezitë e Beshirit, ku vërshojnë mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe përpjekja e pandërprerë për të ruajtur të paprekura dashurinë për atdheun, gjuhën shqipe, familjen dhe vendlindjen.

Tatjana Parllaku që në vitet e rinisë së saj ka qenë një mësuese shembullore, vlerësoi veçanërisht peshën e mendimit filozofik në poezitë e këtij libri, i cili mbetet aktual edhe në ditët tona. Këtë, tha ajo e gjejmë, ndër të tjera, në poezinë “Fati”, ku shkruan:

“Si nuk u bëra një ditë rehat,/ Kokën në jastëk kurrë s’e kam vënë./ Të rroj si qeni e pata fat,/ Më doli gjumi pa më zënë.” (fq.74).

Po aq domethënëse sipas znj. Parllaku është edhe poezia “Jeta qenka një batak”, ku autori shprehet: “Jeta qenka një batak/ Ku për të arritur te lumturia, /Duhet të shkelim njëri-tjetrin/ Vallë, përse lindim fëmijët tanë,/ Kur s’e dimë fundin e tyre?/ Ndoshta shpresat për një ndryshim tjetër/ E bëjnë jeten një refren të përtjetshëm”. Fq. 131).

PESHA E MENDIMIT FILOZOFIK NË LIBRIN “GURI I SHKULUR”

Kur Luan Cala, më besoi redaktimin e librit me poezi të babait të tij, Beshirit, nuk hezitova sepse me të kam patur njohje të herëshme. Në kontaktet me të, (sa qe gjallë Beshiri - një emër i njohur ndër miqtë e tij të shumtë artistë e shkrimtarë në Tiranë e në rrethet e ndryshme të vendit, si në Gjirokastrë, Durrës, Peshkopi, etj), kam patur rastin të njihem edhe me disa poezi të tijat në dorëshkrim, të cilat i vlerësoja për mendimin e thellë dhe mjeshtrinë artistike befasuese. Të njejtën ndjesi provova edhe me kompjuterizimin dhe njëherësh redaktimin e vëllimit të tij poetik “GURI I SHKULUR”. Që në fillim dua të pohoj se si redaktor i tij, u ndjeva mirë, që në këtë sprovë isha në të njejtën linjë me miqtë e mi poetë: Shpendi Topollaj, Vasil Premçi e Sakip Cami, tre shkrimtarë të mirënjohur ish - ushtarakë, që e kanë njohur

nga afër autorin e këtij libri, vlerësimet e të cilëve janë në kapitullin: “Kritika letrare për poezinë e Beshir Calës”. Kështu, Shpendi Topollaj, duke parë metaforat e figurat e zgjedhura letrare, konkludon se “ky autor e njeh mirë poezinë dhe rregullat e saj metrike, ndonëse shpesh përdor edhe vargun e çrregullt”...dhe se “Duke qenë spontan, pra duke i kushtuar më shumë vëmendje kumtit, ai na shfaqet krejt i natyrshëm, dhe pikërisht kjo natyrshmëri i shton hijeshinë vargjeve të tij”. Në promovimin e këtij libri, shkrimtari i mirënjohur Shpendi Topollaj (autor i mbi 70 librave të gjinive të ndryshme letrare), ndër të tjera tha: “Kur rasti e solli tani që Beshir Cala s’është më, që të ritakohesha me të, duke lexuar poezitë e tij të dikurshme, që m’i solli miku im Halil Rama, kuptova se intuïta ime nuk kishte gabuar aspak. Ai ndofta i kishte shkruar ato jo për t’i botuar ndonjëherë, por ashtu, sa për t’i dhënë shkrim ndjenjave, mbresave dhe emocioneve të tij, por ato tregonin më së miri se Beshiri ishte njeri me kulturë dhe sidomos me një zemër të pastër e të ndjeshme, me një zemër që i donte njerëzit dhe vetë jetën”.

Po ashtu, Vasil Premçi vlerëson se “Në poezinë e Beshir Calës, realiteti nuk zbulohet — ai pranohet siç është: i ashpër, i thyer, shpesh i dhimbshëm, por gjithmonë i vërtetë. Që në kontaktin e parë me këto vargje, ndjehet një realizëm i hidhur, një ndjesi se jeta nuk filtrohet, por rrëfëhet në gjendjen e saj më të zhveshur”. Kësisoj, më shumë se sa për titullin intrigues, ky libër të tërheq që në fillim dhe të mbërthen në leximin e të gjitha poezive, për vetë formën e veçantë kompozicionale me tre kapitujt e tij: “Poezi të zgjedhura”, “Poezi njëstrofëshe” dhe “Refleksionë në vargje”.

Në vëllimin “Guri i shkullur”, malli dhe dashuria për atdheun, prindërit dhe vendlindjen, shprehur me mjeshhtëri artistike, me një gjuhë të pasur dhe figuracion të zgjedhur poetik, herë si një trishtim i lehtë, herë si një klithmë e thellë shpirtërore, përshkon si një fill i blertë dhjetra vjersha të librit. Në të vërshojnë mendimet dhe ndjenjat e gjalla të njeriut, përpjekjet për të ruajtur të paprekur dashuritë nga dora rrënimtare e së keqes. Më të dukshme këto në poezitë njëstrofëshe me titujt: “SOFRA VIRANE”, “SA PAK LUMTURI”, “LËMA”, “SI TURIST TË VIJA”, “SA SHUMË I PASKAM RËNDUAR KËSAJ TOKE”, etj. Mjaftojnë qoftë edhe vetëm këto poezi për të vlerësuar peshën e mendimit filozofik në poezinë e Beshir Calës.

Për vlerat ideartistike të librit “Guri i shkullur” të Beshir Calës, foli edhe poetja, prozatorja dhe analistja e mirëfilltë e letërsisë EMRIE KROSI (e vlerësuar si një aset i çmuar i kritikës letrare”, e cila u ndal veçanërisht në kapitullin e dytë “Poezi njëstrofëshe”.

Parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, ky libër bart vlera shumëdimensionale, jo vetëm për lëndën tejet të pasur e të larmishme, por parasëgjithash për stilistikën e veçantë të këtij autori, gjuhën e pasur dhe mjetet shprehëse domethënëse.



BESIM NDRREGJONI: BESHIR CALA RRESHTOHET ME ELITËN KRIJEUERE KOMBËTARE

Presidenti i Unionit të të Përndjekurve Politikë Besim Ndregjoni, ndër të tjera tha se i ka lexuar me një frymë poezitë e librit “Guri i shkullur”. Ai e vlerësoi Beshir Calën një poet që i këndon natyrës, vendlindjes, dashurisë, familjes... “Mbi të gjitha poeti Cala e paraqet ‘gurin e shkullur’ jo si përdorim të metamorforzës që ‘shkulet’, por kudo që shkon ai ka peshën e tij kulturore - artistike, që shëtit por nuk shkulet për t’u harruar!”.

Duke veçuar poezinë “Sikur”, Ndregjoni thotë se poeti vërtetë i këndon Gjirokastrës, qytetit të kalldrëmeve, por i shton këtij qyteti edhe Korabin madhështor të Dibrës, vendlindjes nga vinte autori.

“Beshir Cala nuk harron që t’iu thur poezi, artistëve me përmasa botërore që i dënoi diktatura komuniste, si artistit të madh, tenorit të përmasave artistike botërore Lluk Kaçaj. Po ashtu, mes poezive brilante që vërshojnë si valët e Drinit, ai thur elegjinë kushtuar djalit të tij që humbi jetën në vitin 2000. Thjeshtësia dhe dashuria njerëzore e Beshir Calës tregohen dhe në poezitë e tij të botuara mbas kalimit në amshim! Poezia e tij do të krenojë jo vetëm Dibrën por mbarë kombin shqiptar! Një nderim kam dhe për redaktorin, studiuesin Halil Rama - Mjeshër i Madh, që i ka sistemuar dhe ndarë në disa kapituj

këto poezi, duke i bërë për lexuesin të dashura dhe të kuptueshme. Beshir Cala rreshtohet në poezi me poetët tanë kombëtar. Poezinë e tij ai e shtron në sofrën dibrane dhe e lartëson në piedestalin kombëtar si një krijues i paarritshëm në letërsinë kombëtare”, tha ndër të tjera Besim Ndregjoni në fjalën e tij.

Prof. asoc. dr. HAJRI MANDRI, gjatë promovimit të librit, tha se nuk ka më bukur se ta kujtojmë Beshir Calën, këtë personalitet të shquar të kulturës tonë kombëtare, i cili në gjysëm shekulli kontribuoi në organizime kulturore si skenarist, libretist, aktor dhe regjisor profesionist. Duke folur për poezitë që ka lënë në dorëshkrim dhe që redaktori Halil Rama e djali i tij, Luan Cala na i sjellin të plota në këtë vëllim poetik, Mandri gjykon se ato janë biografi estetike që pasqyrojnë botën e tij të ndjenjave dhe emocioneve, të bindjeve dhe qëndrimeve, të zgjidhjeve të mençura në situatë të ndërlikuara e të vëshirta të jetës.

“Personaliteti dhe formimi i tij kulturor nuk erdhi nga hiçi, por nga konteksti kulturor familjar brenda familjes së Selman Calës nga Lugje Dibrë, një familje e rrallë dibrane që gjeneronte fuqishëm edukim estetik”, tha prof. Mandri.

MODERIMI MJESHTËROR DHE INTERPERETIMI I POEZIV TË BESHIRIT

Aktori, regjisor i skenaristi Llesh

Vijon në faqen 16

PROFILI

Në respekt e mirënjohje për ushtarakun, gjeneralin e shquar të Ushtrisë Popullore Hysen Ali Shehu - Hormova

HYSEN SHEHU GJENERAL I SHQUAR DHE KLERIK I LARTË SHQIPTAR

(vijon nga gazeta "Veterani" nr. 5 (454) maj 2026- fq. 11)

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI;
Dr. në proces Robert SHEHU

Këtu për rastin e ushtarakut madhor Hysen Shehu. shkollon për shtat shprehja popullore "Bëmë Baba të të ngjaj". Në situatën e largimit nga ushtria Hysen Shehu merr vendimin dhe shkon në vatanet e tij, shpërngulet në Hormovë, restoracion teqenë dhe shtepinë, vatanin ku u lind dhe u rrit. Ndërkohë që rrugët e besimit ishin plotësisht të hapura me propozim të K.M.SH, Hysen Shehut i akordohet një rrugëtim me Delegacionin Shqiptar për në Mekë të Arabisë për të kryer Haxhin, qëndron në Arabi një muaj dhe merr titullin Haxhi, titull që në fakt është domosdoshmëri për çdo udhëheqës shpirtëror.


Hysen Shehu gjenerali erudite i ushtrisë në moshën 53 vjeçare ju përkushtua tërësisht besimit halvetian. Profecia e Sheh Mehmet Camës u vërtetua në vitin 1994 kur përfaqësuesi i brezit të shtatë, Sheh Hysen Ali Shehu Hormova filozof i menëur dhe klerik i brezit të shtatë rihapi teqenë halvetiane të Hormovës. Sheh Hyseni ka kontribuar denjësisht që shërbesat fetare të jenë të kuptueshme, të thjeshta, të mirëpritura nga komuniteti helvetic dhe më gjerë. Ai ka luajtur rol pozitiv për mirëkuptimin fetar në jug të vendit, duke respektuar klerikët, besimtarët, ritet e festat fetare të të gjithë besimeve në një unitet të harmonizuar. Ai e ka kthyer teqenë në Hormovë një faltore të të gjitha besimeve, pasi aty gjen klerikë nga të gjitha besimet, si një faktor dhe aktor i rëndësishëm në faljen e gjaqeve në fshatra e krahina të trevës jugore, por është edhe një kontribues e mbështetës për zhvillimin ekonomik, kulturor, ndjenjën atdhetare në Hormovë, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Gjirokastrë e më gjerë. Një numër i konsiderueshëm fondacionesh kulturore, fetare e shoqërore e kanë zgjedhur Sheh Hysenin në bordet e tyre, ndërkohë që ka bërë vizita të rëndësishme si klerik edhe në Arabi Saudite (Mekë e Medine), në vendet e shenjta të familjes Profetike (El-libejtit), Qerbel, Teheran (Iran), Turqi, Vatikan, Itali, Izrael, Maqedoni të Veriut, Kosovë, në Samitin Botëror në Korenë e Jugut më 2020 etj. Kështu në shkurt 2020 mori pjesë në ekipin e Ambasadorëve të Paqes që shkuan në Samitin Botëror të Paqes, organizuar në Seul, ku midis tetë besimeve fetare botërore që përfaqsheshin në atë Samit, Sheh Hyseni përfaqësonte gjithë klerin shqiptar. Ai është jo vetëm një peligrin shembullor por dhe ka mbajtur kumtesa me karakter religjionar, social, etnik, ekumenik etj. Në fushë publicistike është botues i gazetës "Rreze Halevjane" (ka qenë gazetë e përmuajshme që nga viti 1995), si dhe ka disa vëllimeve poetike e fetare. Për veprimtarinë e tij ushtarake, intelektuale, fetare, sociale, kulturore dhe atdhetare, Sheh Hysen Ali Hormova është vlerësuar me dekorata e medalje të karakterit ushtarak si medalja për shërbime të shquara ushtarake, medalja "Ylli i Kuq", por edhe me titullin "Nder i Qarkut" të Gjirokastrës, "Ambasador i Paqes" së bashku

me bashkëshorten inxhinieri Florën, nder dhe krenari edhe për dy vajzat e tij njera 52 dhe tjetra 57 vjeçe që janë të martuara dhe që kanë krijuar jetën e tyre në shtetin fqinj në Itali, por që janë gjithmonë present në botën, shpirtin dhe zemrën e prinderve të tyre të mirë. Federata për Paqe në Botë i ka akorduar Sheh Hysenit titullin "Ambasador për Paqe"(2017), me aktivitet të gjerë si brenda vendit dhe në botë. Federata Universale e Paqes Botërore e ka emëruar Sheh Hysenin kryetar i kësaj federate për degën e Tepelenës dhe aktualisht është nënkryetar i kësaj Federate për gjithë Qarkun e Gjirokastrës. Kohët e fundit një forum i Imazhit Shqiptar në botë e ka nderuar me titullin "Ambasador i Imazhit Shqiptar në Botë". Në mënyrë të përvitshme Sheh Hyseni në teqenë halvetiane të Hormovës, çdo 23 prill i vishen si bleta besimtarë nga jugu i vendit dhe nga e gjithë Shqipëria. Natyrshëm data 23 prill është ditë përkujtimore e veçantë sepse në shtatë breza Ali Hormova ka merita të jashtëzakonshme dhe për më tepër Sheh Aliu ka ditën e lindjes pikërisht më datën 23 prill 1902 dhe që përkujtohet në mënyrë të përvitshme në Hormovë. Sheh Aliu, atdhetari halvetian dhe kleriku më i spikatur dhe me reputacion të madh i kësaj teqeje në konferencën e vitit 1950 (sipas fondeve dokumentare të AQSH e zgjedhi Sheh Ali Hormovën kryetar të tarikatit Halveti, në bazë të ligjit nr. 743, datë 26.11.1949 dhe nenit 8 të Statutit të Komunitetit Mysliman 1950, që ishte pjesë e këtij Komunitetit Mysliman Shqiptar.

HISTORIA E TARIKATIT HALVETIAN ËSHTË PASURI QË SHPREH E MBRON UNITETIN NDËRFETAR SHQIPTAR

Halvetizmi nga të dhënat që kemi marrë nga Sheh Hyseni është themeluar prej Sej - Jid Hasan Basri, i cili ka qenë një prej 17 besnikëve të Hazret Aliut, që mbante titullin Sej - Jid sepse rridhte prej familjes profetike. Ndërsa kleriku që i dha formën institucionale ishte nga Maroku dhe quhej Ymer Halvetiu prej të cilit kanë rrjedhur 36 udhëheqës shpirtëror. Halvetizmi i përket degës shite të Halvetizmit ose të "Dervishizmit të vërtetë". Në vendin tonë ky tarikat është përbërë e Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe është përhapur, që prej shekullit të XVII. Të dhënat flasin se ka ardhur në Shqipëri në drejtimin jugor; Artë - Janinë - Delvinë - Gjirokastrë - Tepelenë - Përmet - Berat - Skrapar - Korçë - Elbasan - Tiranë dhe në drejtimin verior: nga ish-Jugosllavia (Serazi) - Kosovë - Tropojë - Kukës - Shkodër - Tiranë. Organizimi i parë i tarikatit halvetian u bë në kongresin e parë Halvetian në 1923 ku ndarja administrative e Komunitetit Mysliman Shqiptar nga Sheriati Islam i Perandorisë Osmane u bë me ligjërimitin e Statutit Legal për të gjitha Komunitetet Fetare shqiptare, me nr 432, datë 3 erisor 1923 nga Shteti Shqiptar. Në Kongresin e parë të Komunitetit Mysliman shqiptar përfaqësues i Tarikatit Halveti ishte Sheh Ibrahim Karbunara, ndërsa në të dytin në Berat në qershor 1930 kryetar i tarikatit, u zgjedh Sheh Ahmet Pazari. Edhe pse u kërkua që tarikatit Halveti

të shkëputej nga Komuniteti Mysliman shqiptar dhe të ligjërohej Komunitet fetar më vehte, me Vendim nr 418 datë 31.7.1934 të Këshillit të Ministrave nuk u miratua kërkesa e sektit Halveti. Kongresi i radhës për halvetinjtë ishte i treti që u mbajt më 1937 në Tiranë, me kryetar Sheh Qerim Bilishti. Pas çlirimit në vitin 1950 u bë kongresi i katër në Tiranë ku kryetar i tarikatit Halveti, u zgjedh Sheh Ali Hormova, ndërkohë që u bënë edhe përpjekje për tu përbashkuar me komunitetin Bektashian; kongresi i pestë i Halvetinjtë u mbajt në Tiranë më 1994 ku kryetar i sektit u zgjedh Sheh Muhamer Pazari. Kongresi i gjashtë i tarikatit Halveti u mbajt në Hormovë në vitin 2019 ku kryetar u zgjedh Sheh Hysen Hormova, që vijon edhe aktualisht. Me Gjeneralin dhe klerikun Hysen Shehu ka rënë rasti të jemi në shumë aktivitete. Ai është njerëzor me logjikë e argument të fortë, të shpreh çfarë i mban zemra dhe nuk shëron pa logjikë, është me fjalë melhemn por dhe i drejtëpërdrejtë. Ai di të futet djalërisht edhe në dhomën me tetë faqe, do të reflektojë, di të tregojë për çdo dekadë, di të japë mësim historie e jete, di të orientojë se si komuniteti të mësojë nga e djeshmja, se si ta jetojë të sotmen dhe si të shpresojë për të ardhmen. Sheh Hyseni është një personalitet smart, mjaft aktiv, dinamik e punëtor, orator argumentues, gjykues e analizues, është i kudogjendur për Hormovën, bashkëfshatarët, besimtarët, nevojëtarët, di të flasë e sqarojë njerëzinë jo vetëm me fjalën por edhe me zemër të pastër, di të ruajë raporte të shkëlqyera me disa klerikë veçanërisht më Dervish Mikel Onjenë e Fushëbardhës që shërben në Turan, Dervish Ermalin dhe me dhjetra e qindra klerikë të tjerë të të gjitha besimeve. Sheh Hyseni ka një aktivitet të shumëanshëm, pasi ka mbajtur disa kumtesa me karakter religjionar, social, etnik, historik, etnologjik, filozofik etj. Ai vijon të ketë kontakte të shumta në: Sarandë, Delvinë, Kurvesh, mbarë Labërinë, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Fier, Mallakastër, Vlorë, Tiranë etj. Në këtë kuadër Sheh Hyseni bashkëpunoi fuqishëm edhe me ish-Prefektin Astrit Alia, dhe si anëtar i Komisionit shkencor dhe organizativ në zhvillimin e Konferencës Shkencore Kombëtare: "Prefektura e Gjirokastrës gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore 1939 - 1944", mundësuan zhvillimin e saj me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut, në Gjirokastrë 26.11.2019 me pjesëmarrje shumë të gjerë. Sheh Hyseni është një faktor ekuilibri në gjithë trevën jugore shqiptare e më gjerë duke qenë edhe anëtar i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Labëria", pjesëmarrës në shumë aktivitete të saj. Është merita e tij që me aftësinë dhe komunikimin me pushtetarët mundësoi shtrimin dhe asfaltimin e rrugës së Hormovës, riparimin e urës, ujësjellësit të fshatit, të vendeve historike etj. Ai ka mbështetur e shumë shqiptarëve që jetojnë e punojnë jashtë vendit si në: SHBA, Itali, Greqi, Gjermani etj. Ai mban korrespondencë me shqiptarët e trojeve në: Tetovë, Gostivar, Strugë, Shkup, Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Ulqin, Tuz etj. Që nga viti 2003, Ai është botues i gazetës së përmuajshme "Rreze Aleviane", e cila është ndërprerë përkohë-



sisht. Sheh Hyseni është autor i disa vëllimeve poetike dhe fetare. Në Hormovë gjen shpesh dervishë, baballarë, myftinjë, priftërinj ortodoks e katolik etj., pasi marrëdhëniet me komunitet fetare janë të shenjta. Ruajtja e vendeve të shenjta të krishtera, për tre kishat dhe Manastirin e Hormovës është trashëguar tek gjithë besimtarët. Traditën e Sheh Aliut që kishte miqësi me At Gjergj Sulin e Leklit e vazhdon Sheh Hyseni, që ruan raporte me shumë klerikë dhe në festën e 23 prillit ngjisin maloren drejt Hormovës edhe mjaft priftërinj të besimeve ortodokse e të krishterë, ndërkohë që marrëdhëniet me shkollën "Xhuzeppe Grass" në Gjirokastrë, me universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë etj. Sheh Hysenin e gjen pranë objekteve të kulteve të tjera, në çdo festë e ceremoni fetare lokale e kombëtare dhe kjo e bën një figurë të dashur mbarë popullore. Si ish-ushtarak dhe klerik i shquar, Hysen Shehu ndjehet krenar që ka mbjellë fidanë më të shëndoshë se vetja, që ka nxjerrë nga bangat e shkollës ushtarake gjeneralë e ushtarakë dinjitozë, ushtarakë patriot dhe atdhetar, që u ka edukuar karakteristikën më të mirë tek njerëzit që është mjaft e vyer siç është mirënjohja, që ka nxjerrë fisnikë, modestë që ka kultivuar mësimin e madh, "duajni dhe respektoni edukatorët që ju kanë mësuar, edhe në qoftë se bëheni me të ditur dhe më të sukseshëm se ata, tregohuni modest, sepse atherë jeni në rrugën e drejtë, kështu kalcifikoni të ardhmen tuaj edhe më të mirë.

PERSONALITETE HISTORIKE

Ukshin Hoti, mendimtar i që jetoj përtej kohës së tij

• *Ukshin Hoti është më shumë se një emër historik. Ai është simbol i rezistencës intelektuale shqiptare. Figura e tij qëndron mes mendimtarit dhe martirit — një njeri që nuk mori armë në dorë, por mbrojti me vendosmëri idenë e lirisë dhe dinjitetit kombëtar*

Rajmonda Malecka

Ka figura historike për të cilat është e pamundur të shkruash vetëm me mendje. Sa herë përmendet emri i Ukshin Hoti, ndërhyjnë edhe zemra, sepse ai nuk ishte thjesht një intelektual apo një figurë politike e kohës së vet. Ai ishte ndërgjegje kombëtare, vizion dhe sakrificë e gjallë. Në jetën dhe mendimin e tij bashkëjetonin filozofi, guximi dhe dhimbja e një populli që kërkonte lirinë.

Në historinë e kombit shqiptar ka emra që mbeten të gdhendur jo vetëm në libra, por në kujtesën shpirtërore të njerëzve. Ukshin Hoti është një prej tyre. Ai nuk jetoj për privilegje personale, as për lavdi politike. Jetoj për idenë se një komb duhet të dijë të mendojë për veten, të njohë historinë e tij dhe të ndërtojë të ardhmen me vetëdije e dinjitet.

Në një kohë kur shumë heshtnin nga frika, ai zgjodhi të fliste. Kur kompromisi dukej rruga më e lehtë, ai zgjodhi bindjen. Pikërisht kjo e bëri të veçantë: nuk ishte vetëm njeri i rezistencës, por njeri i mendimit të lirë. Ai besonte se liria nuk fitohet vetëm me armë, por edhe me dije, kulturë politike dhe përgjegjësi historike.

Nga fshati i vogël i Krushës së Madhe deri në auditorët universitarë të botës dhe burgjet e errëta serbe, rruga e tij ishte e mbushur me sakrificë. Por asnjë vuajtje nuk arriti ta thyejë. Edhe në çastet më të vështira, ai ruante qetësinë e mendimtarit që e dinte se historia është më e madhe se frika individuale.

Fëmijëria dhe formimi i hershëm

Ukshin Hoti lindi më 17 qershor 1943 në Krushë të Madhe të Rahovecit, në një familje të thjeshtë shqiptare. Ishte fëmija më i madh i shtëpisë dhe qysh herët tregoi një natyrë të veçantë: vëzhgonte gjithçka, pyeste vazhdimisht dhe përpiqej të kuptonte arsyet e padrejtësive që shihje përreth.

Babai i tij, Nazifi, mbante një kioskë gazetash pranë shkollës së fshatit. Pikërisht aty, mes gazetave dhe lajmeve të kohës, nisi edhe kontakti i parë i Ukshinit me botën e ideve. Ai lexonte me etje dhe mendohej të kuptonte zhvillimet politike e historike që ndikonin fatin e shqiptarëve.

Në moshë të re, ai kishte krijuar bindjen se padituria është një nga robëritë më të mëdha të një populli. Për këtë arsye, dijen nuk e pa kurrë si privilegj personal, por si detyrim ndaj kombit. Çdo pyetje që lindte në mendjen e tij lidhej me fatin e njerëzve të vet: pse shqiptarët jetonin të ndarë, pse mungonte barazia dhe si mund të ndryshohej kjo gjendje. Këto pyetje do ta sho-

qëronin gjatë gjithë jetës.

Rruga akademike dhe horizonti ndërkombëtar

Ukshin Hoti u formua si një ndër intelektualët më të përgatitur shqiptarë të kohës së vet. Ai studioi dhe u specializua në fusha të marrëdhënieve ndërkombëtare, filozofisë politike dhe diplomacisë, duke kaluar edhe në universitete prestigjioze amerikane si Harvard University, University of Chicago dhe University of Washington.

Në vitin 1978 fitoi bursën prestigjioze Fulbright, një arritje që dëshmonte nivelin e tij të jashtëzakonshëm intelektual. Përmes përvojës në Shtetet e Bashkuara, ai u njoh me sisteme të ndryshme politike dhe me debatet më të avancuara akademike të kohës. Megjithatë, sa më shumë zgjerohej horizonti i tij ndërkombëtar, aq më shumë thellohej lidhja me çështjen shqiptare.

Ai nuk e përdori dijen për karrierë personale. Përkundrazi, kërkoi ta kthente atë në shërbim të Kosovës dhe shqiptarëve. U bë urë lidhëse mes botës akademike shqiptare dhe asaj ndërkombëtare, duke ndihmuar në zhvillimin e Universitetit të Prishtinës dhe në afrimin e profesorëve e studiuesve nga Shqipëria. Për të, arsimit nuk ishte vetëm formim profesional. Ishte mënyra më e fuqishme për ta bërë një komb të vetëdijshëm për veten.

Filozofia politike dhe vizioni kombëtar

Vepra e tij më e njohur, Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare, mbetet një ndër analizat më të thella politike të mendimit shqiptar modern. Në të, Ukshin Hoti trajtonte çështjen kombëtare jo si emocion romantik, por si problem historik dhe politik që kërkonte zgjidhje të menjëhershme e afatgjatë.

Ai besonte se shqiptarët duhej të ndërtonin strategji dhe jo vetëm reagime emocionale. Për të, vetëdija kombëtare ishte themeli mbi të cilin ndërtohej liria. Një komb pa vetëdije politike rrezikon të mbetet gjithmonë i manipuluar nga rrethanat dhe interesat e të tjerëve.

Ukshin Hoti mendonte se bashkimi kombëtar nuk duhej parë si slogan, por si proces historik që kërkonte maturi, kulturë politike dhe përgjegjësi. Ai nuk ishte njeri i retorikës boshe. Ishte realist politik, që kuptonte balancat ndërkombëtare dhe rëndësinë e mendimit strategjik.

Në diskutimet me studentët dhe bashkëvuajtës, ai përsëriste shpesh se një popull duhet të mësojë të mendojë për të ardhmen, jo vetëm të vuajë të tashmen.

Qëndresa në burgje dhe mendimi progresist

Arrestimi i tij më 21 maj 1982 ishte përpjekje për ta heshtur një zë që shqetësonte pushtetin jugosllav. Ai u akuzua për veprimtari armiqësor dhe për “rrezikim të rendit federativ”, por në thelb faji i tij ishte mendimi i lirë.

Kaloi në burgje të ndryshme: në Prishtinë, Zagreb, Lubjanë, Nish e Dubravë. Ishin vite të rënda izolimi, presioni dhe represioni. Por edhe aty, ai nuk reshti së menduari dhe së shkruari.

Shokët e burgut kujtojnë se ai krijonte “orë mendimi”, ku diskutonte filozofi politike, historinë e kombeve dhe të drejtën e vetëvendosjes. Edhe kur iu ndaluan librat dhe stilo-lapsat, ai rindërtonte nga kujtesa teori të tëra politike dhe i ndante me bashkëvuajtësit.

Një i burgosur i ri kishte hyrë në qeli i mbushur me zemërim dhe dëshirë hakmarrjeje. Ukshini i kishte thënë: “Zemërimi pa mendim bëhet verbëri. Ne duhet të jemi më të mençur se ata që na burgosin.”

Kjo fjali përmbledh gjithë filozofinë e tij politike: rezistenca duhej të ishte edhe morale, edhe intelektuale.

Gjatë një greve urie 12-ditore për kushte më dinjitoze, ai tregoi një forcë të jashtëzakonshme karakteri. Edhe kur trupi dobësohej, fjala e tij mbetej e kthjellët. Për të, dinjiteti njerëzor nuk ishte privilegj, por e drejtë themelore.

Familja nën peshën e përndjekjes

Represioni ndaj Ukshin Hotit nuk mbeti vetëm mbi të, familja e tij përjetoi pasojat e rënda politike dhe sociale. Motrat dhe vëllezërit u përballën me largime nga puna, ndalime profesionale dhe presione të vazhdueshme.

Por familja e tij mbeti stoike. Ata e kuptonin se rruga që kishte zgjedhur Ukshini ishte e vështirë, por e ndershme. Sakrificat e tij ishin sakrificat për një ideal më të madh. Kjo e bënte figurën e tij edhe më njerëzore. Pas filozofit dhe politikanit qëndronte një bir, një vëlla dhe një njeri që pagoi me jetën personale besnikërinë ndaj bindjeve të veta.

Dubrava dhe misteri i zhdukjes

Maj 1999 mbetet një nga plagët më të mëdha të historisë së tij. Pas bombardimeve të NATO-s mbi zonën e burgut të Dubravës, shumë të burgosur shqiptarë u vranë ose u zhdukën. Mes tyre edhe Ukshin Hoti.

Sipas dokumenteve zyrtare, ai duhej



të lirohej më 16 maj 1999. Dëshmitarë të ndryshëm kanë deklaruar se e panë për herë të fundit pikërisht atë ditë. Më pas, çdo gjurmë humbi. Zhdukja e tij mbeti mister dhe plagë e hapur për familjen dhe kombin shqiptar. Vitet kaluan, por pyetja mbeti e njëjtë: çfarë ndodhi me Ukshin Hotin?

Megjithatë, historia shpesh ka paradokset e veta të mëdha. Trupi i tij u zhduk, por mendimi i tij u bë edhe më i pranishëm.

Një figurë që u kthye në simbol

Sot, Ukshin Hoti është më shumë se një emër historik. Ai është simbol i rezistencës intelektuale shqiptare. Figura e tij qëndron mes mendimtarit dhe martirit — një njeri që nuk mori armë në dorë, por mbrojti me vendosmëri idenë e lirisë dhe dinjitetit kombëtar.

Ai u mësoi brezave se kombi nuk ndërtohet vetëm me emocion, por me kulturë politike, dije dhe durim historik. Intelektuali, sipas tij, nuk duhet të jetë spektator i historisë, por ndërgjegjja e saj. Në një kohë ku shpesh triumfojnë zhurma dhe interesat e ngushta, figura e tij mbetet kujtesë se mendimi i lirë është forma më e lartë e qëndresës.

Ukshin Hoti mbetet një nga figurat më të ndritura dhe më tragjike të historisë moderne shqiptare. Ai jetoj me bindjen se liria fillon në mendje dhe se një komb pa vetëdije rrezikon të humbasë drejtimin e vet historik.

Në qelitë e ftohta ai nuk ndërtoi urëjtje, por ide. Në izolim ai nuk u thye, por u bë edhe më i fortë shpirtërisht. Dhe në heshtjen e zhdukjes së tij, ai u kthye në zë të përhershëm të ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Një trup mund të zhduket. Por një mendim që lind nga e vërteta dhe sakrificat jeton përgjithmonë.

TË MËPARSHME E TË THANA TË TASHME

VLERAT SHËRUESE TË RAZMËS

Leopold Loro Shkreli

Razma bën pjesë në njësinë administrative të fshatit Vrith, Komuna e Shkrelit, Bashkia Malësia e Madhe. Distanca e rrugës me makinë nga qyteti i Shkodrës për në Razëm është 41 km, ndërsa nga bregdeti (Velipoja) është 65 km. Gjendet në një lartësi prej 900 m mbi nivelin e detit. Shtrihet në rrëzë të malit të Veçeçikut, në veri-lindje të tij, dhe rrethohet nga male të larta. Ajo është e vendosur në një pllajë karstike me kontraste të theksuara relievi. Ambienti është tipik alpin, me pyje të dendura ahu e pishash, me livadhe të gjelbërta me lloj-lloj lulesh. Mikroklima mesdhetare malore, me nuancë kontinentale, krijon kushte të favorshme me vlera shëruese për sëmundjet e frymëmarrjes, duke vepruar shpejt dhe në mënyrë mahnitëse në organizmin e njeriut.

Të tregosh për vlerat e vendit tënd



nuk është kurrë vonë. Shumë persona, për gjendjen e mirë shëndetësore që gëzojnë sot, falënderojnë Zotin dhe Razmën, vendin ku gjetën shërim. Cilindo nga banorët e Malësisë së Madhe që ta pyesësh për Razmën, do të të flasë më parë për vlerat e saj shëruese dhe më pas për vlerat turistike të këtij vendi dhe kanë "shumë çka me shtue". Të shkruash për vlerat shëruese të Razmës është një detyrë e rëndësishme që më ka nxitur vazhdimisht. Në këtë shkrim po paraqes artikuj të gazetave ndër vite, dëshmi të personave që e njohin mirë këtë vend, si dhe dokumente shkresore që e trajtojnë atë. *** Në fletoren e përditshme "Gazeta e Re", të shoqërisë aksionere "Tipart" (Tiranë), në artikullin, "Për një stacion klimatik pranë Shkodrës", e dielë, datë 16 qershor 1929, ndër të tjera shkruhet: "Jo larg qytetit asht një vend krejt i bukur dhe i pajisun prej natyret, i quajtnun Raza e Vrithit, i cili asht 800 m. mbi nivel e detit. Ky vend mund të bahet një stacion klimatik ndër ma të mirët për ajr e ujë e mirë qi ka. ...Po të ndreqet udha deri në vendin ku thamë se mund të bahet një stacion klimatik dhe, po t'u jipen disa lehtësi dhe

përkrahje atyne që duen të ngrihin hotele dhe lokale konforti, puna kishte për tu krye më së miri në dobi të madhe të shëndetit dhe t' ekonomisë së popullit. Foto në oborin e shtëpisë tonë në Razëm në vitin 1940. E ndjera motra ime Albina e veshur me kostumin tradicional të malësisë. 2 Do t'i luteshim pra më së pari Ministrisë së Punvet Botores, qi t'apë dizpozita për ndërtimin e udhës deri te Raza e Vrithit, e mëndej Ministrisë s'Ekonomisë Kombëtare dhe të Financavet, për përpilimin e një ligjë me të cilin u ipen perkrähje atyne që duan të ngrihin hotele e lokale banimi e konforti ner stacione klimatike, tuj i akordu trojet pa pagesë, si dhe tue perjashtuem prej takses doganore e tjera, materijalin për ndërtimin të ndërtesave të stacioneve". Në një tjetër gazetë politike të përditshme që dilte në Tiranë, me emërtesën "Besa", në artikullin "Rruga e Vrithit" e premtë, datë 19 Prill 1935, ndër të tjera shkruhet: "...Lajmohemi se në këto ditë fillojnë përsëri punimet për çeljen e rrugës së Vrithit. Qëllimi i qeverisë asht me e krye këtë rrugë sa ma parë, që të jetë e mundun, vetun se vendi i quajtnun Razna, ku shkon rruga, asht vend klimatik që ka me sherbye teper turizmit e sidomos atyne që kan me pasë nevojë për ndrrim ajri". E njëjta gazetë, pak ditë më pas, në artikullin "Hapja e rrugës Vrith-Razna", e hanë, 10 qershor 1935, njoftonte: "Me shumë gëzim u informuem dje prej injjinerit të Botores së këtushën Z. K. Manise, rruga deri në Razna ishte hapë, dhe ai vetë kishte vajtë me automobil. ... Rruga e Raznës siguron një nder vendet ma klimatike nder bjeshkët e kësajë kra-hine per ajrin e pastër e bjeshkuar, për ujin e ftohët e në naltësinë ma se 1000 metra nalt nga sipërfaqja e detit, me panoramen e bukur të ati vendi afer Veçeçikut, terheq vizitoret dhe banuesit per ndrrim ajri. Ky vend ka nisë me u përmendë tash ma se pesë vjet per velagjiaturen e bame prej shkodranëve". "Cir-ka", revistë e përkohëshme kultura-le-popullore që dilte në Shkodër, në numrat respektivë të datave 20.06 1937 dhe 14.07.1937, në artikullin vijues: "Në Razna të Vrithit" shkruar nga Rrok Zojzi, ndër të tjera, nënvizonte: "Këtu asht Razna e Vrithit, qendra ma e randesishme klimatike e malcive të veriut sot per sot. ... Razna gëzon, qyshket më të pershtatuna per një vend verimi per popullsinë e qytetit. Disnivele me Shkodrën asht 1000 e pak metra. Nji vend i hapët e i çilun n'at maltesi asht e rrallë nder malcina. Nji klimë e thatë e e terun si aty nuk asht gjia e zakonshme per malsina. ...Dam per ne që rrimë indifrent kundrejt begative të vendit tonë. Dam per ne me kërkue njeti të tilla qendra e me i vu kamen t'onave, vetun se janë tonat. Sikurse dhe detyrë e jona e e shtypit kombëtarë, asht me ja ba të njoftun popullit t'onë bukurit me të cilat natyra e ka veshë ket atdheun tonë të vogel. Bjeshket t'ona jo vetëm nuk ja lënë dalë Lovçanit, Nikshiqit, Koloshinit, Stambollçiqit e të tjera, por i rrinë përbri edhe stacioneve t'Europës së mesme". Nga ar-



Foto në oborin e shtëpisë tonë në Razëm në vitin 1940. E ndjera motra ime Albina e veshur me kostumin tradicional të malësisë.

tikulli "Thethi dhe Razma, pikat e harruara turistike" të gazetares së ndjerë Anila Dushi, botuar në gazetën "Shekulli", datë 16.08.2004, kam shkëputur: "...Razma është një tjetër pikë turistike e qytetit të Shkodrës e shtrirë rrëzë malit të Veçeçikut. ...Ajo është një nga vendet më të bukura dhe me klimën më të shëndetshme në Alpe. Në mes pishave lëndinave mjaft banesa të tipit alpin. ...Razma është një pikë turistike me vlera kurative për sëmundje të ndryshme.... Tradicionalisht në Razëm kanë patur banesat e tyre private shumë qytetarë shkodranë". Në këtë shkrim tërhiqet vëmendja edhe për kujdesin e shtuar që duhet të tregohet, pasi energjia elektrike është shumë e dobët, dhe me kufizime të shumta. "...Razma ka patur problem ujin e pijshëm, por së fundi është ndërtuar ujësjellësi i Komunës së Shkrelit ku ajo përfshihet, dhe uji ka shkuar aty. Por, megjithatë ai nuk menaxhohet mirë, dhe ka probleme për furnizimin me të pasi shpesh uji mungon". Në Buletin Shkencor të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Seria e Shkencave Natyrore, nr. 61, 2011, ff. 29-37, në artikullin "Monitorimi i përqendrimeve të materies së grimëzuar në ajrin e pikës turistike të Razmës", jepen rezultatet e punimit shkencor të një grupi të zgjeruar profesorësh të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Luigj Gurakuqi" dhe të Universitetit të Tiranës, lidhur me monitorimin e ajrit në zonën e pikës turistike të Razmës, në muajt nëntor-dhjetor të vitit 2010. 3 Në konkluzionet e monitorimit, të realizuara me aparataturat më të mira të kohës, rezulton se cilësia e ajrit në zonën turistike të Razmës është shumë e mirë. Në këtë studim, Razma përbën një pikë turistike me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare si për sezonin veror ashtu edhe për atë dimëror. Nga dokumentet shkresorë, tërheq vëmendjen një relacion i datës 23.02.2024, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia



Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, Shërbimi Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor, në të cilin trajtohet zbatimi rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare për minimizimin e riskut dhe të ekspozimit ndaj patogjenit Covid -19. Në këtë relacion citohet: "... Vlen të theksohet se Razma, si atraksion ku klima dhe ajri i freskët janë dominuese, ka pasur një incidencë zero, që do të thotë se numri i rasteve të të infektuarve në Razëm ka qenë zero. Ndërkohë, orientimet e profesionistëve kanë bërë të mundur që rastet me COVID-19, në zonat e tjera me problematika shëndetësore serioze të shfrytëzonin pikërisht këtë zonë, për shkak të klimës, e cila përmban në vetvete vlera të larta oksigjeni dhe, rezultatet kanë qenë të dukshme sa i përket përmirësimit të shëndetit të të infektuarve". Nga dëshmitë gojore, sjell dëshminë e mjekut të njohur infeksionist Pëllumb Piperi, të cilin pata fatin ta njoh gjatë periudhës së COVID-19. Kemi biseduar kryesisht për Razmën dhe, ndamë të njëjtat mendime. Profesori më tregoi që, kur kishte qenë i infektuar me COVID-19, kishte kaluar pesëmbëdhjetë ditë në Razëm dhe ishte ndier i shëruar. Të këshilluar nga ai edhe miq të tij, të cilët ishin të rënduar me COVID-19 dhe të intubuar, kishin ardhur në Razëm dhe, pas pak ditësh, ishin përmirësuar. Më tej ai më theksoi dëshirën e tij për të promovuar vlerat shëruese të Razmës përmes një reportazhi. Dëshmi të tjera sjellin përfaqësues të pushtetit vendor dhe mjekë që kanë shërbyer në këtë zonë. Fred Sterkaj, i cili ndër vite ka mbuluar detyra të rëndësishme në pushtetin vendor, pohon: "Edhe nga të parët e mi e di se Razma është njohur gjithnjë si vendi ku njerëzit gjenin shërim. Gjatë viteve kam njohur personalisht shumë persona që vinin në Razëm për shërim. Në resortin turistik "Kulla e Artë", në kohën e pandemisë COVID-19, vinin bujtës nga e gjithë Shqipëria. Megjithëse nuk e shprehnin, kuptohej se ishin të sëmurë. Në këtë kohë jemi ndier me frikë, si për veten tonë ashtu edhe për personelin e shërbimit. Fatmirësisht nuk kemi pasur asnjë të infektuar, jo

Vijon në faqen 15

HOMAZH

Skënder Xhafer Guri, ish luftëtar i paepur dhe kuadër shembullor

Zef Rozhani

Edhe me plot gojën që gazeta "VETERANI" është bërë një prush i pashuar, që po mban të gjallë qëndresën titanike të brezave luftëtarësh që luftuan dhe dhanë jeten për lirinë e këtij trualli. E ka nga ato mijra që krahas të rënëve punuan dhe luftuan me vetmohim për të çuar deri në fund amanetin e atyre trimave e trimëshave që e vaditën me gjakun e tyre këtë truall, që ky popull i pa epur të gëzonte lirinë e fituar përmes sakrificave të pashoqe. E një ndër ta është edhe veterani S. Krapalli i pa harruari Skënder Xhaferi, nga Turbohova, e këtyre maleve legjendare.

Skënderi lindi në vitin 1927 të shekullit të kaluar, në një familje patriotike dhe atdhetare. Në moshën 16 vjeçare, iu bashkua luftës Nacional Çlirimtare. Urrejtja e patriotëve në mbarë popullsinë ishte bërë aq e madhe sa edhe kjo moshë e re nuk duronte

më thundrën e pushtuesve, por sa ikte njëri vinte tjetri për të mposhtur këtë popull paqedashëz. Ndaj edhe Skënderi me bekimin e prindërve luftonte përkrah trimave që kishin bërë betimin "Ja vdekje ja liri". Ndaj u bë pjesëtar i brigadës 18 Sulmuese "Heroinë e Popullit". Gjatë luftës e plagoset dy herë në luftën e pandërprerë në Vlushë të Skraparit. Ndihi pakursyer bëri që ai të mposhtë vdekjen dhe gjithmonë të ishte në krah të luftëtarëve. Aty ai gjeti atë forcë të pa besueshme duke u bërë dëshmitar i sakrificave dhe pjesëtar në fitoren e lavdishme.

Sapo Shqipëria u çlirua, më dhjetor '44 ish partizanit trim Skënder Xhafer Guri iu kërkua të jepte kontributin e tij në organet e Ministrisë Brendshme të sapo krijuar. Ndaj ai me përkushtim punoi si askush me detyrat që i ngarkoheshin. Megjithatë liria e fituar ishte me çdo vatër shqiptare, kishte nga ato që sabotonin ose mbillnin të keqen, ai me kolegët e tij, ishin në gi-

rin e popullit.

Është e çuditshme por e vërtetë por ky oficer me grada të larta nuk u bë pre e mendjemadhësisë dhe e fodullokut. Si komisar në organet e punëve të brendshme ai u bë modeli i oficerit. Kudo la gjurmë të pashlyera 1944-1983, katër dekada me ato detyra të vështira. Ai e dinte se puna me njerëzit, ndjenjës e detyrës mposht çdo gjë. Ai nuk ishte vetëm epror i mirë për edhe bashkëshort dhe prind shembullor. Baba i dy vajzave të mrekullueshme. Jeta bashkëshortore e lidhur me Hyrije Met Katanja nga Rrushkulli i Shkodrës në vitin 1951, kaluan një jetë për ta patur zili. Ato vajza të mira e bënë 3 herë gjysh dhe disa herë stërgjysh. Edhe pas daljes në pension në vitin 1983 ai nuk u shkëput nga jeta aktive. U nda nga jeta në moshën 93 vjeçare.

Ndaj dhe miku i tij, ish diplomati Gazmir Qamil Bekteshi krenohet me mikun e tij të paharruar, sepse mbi të gjitha ishte njeri.



MIRËNJOHJE

JANI ZHUPI, MËSUESI PASIONANT I GJIMNAZIT "ASIM ZANELI", GJIROKASTËR

Nga: Naxhi Kasoruh, "Mjeshtër i Madh"

Që i vogël kalova para gjimnazit "Asim Zeneli" Gjirokastrë, Panteonit të Arsimit Shqiptar ku në një shekull u përgatitën gjenerata të tëra me kulturë e dije, që do të shërbenin me devotshmëri atdheut e vendit. Mësues pasionant e të devotshëm por të dashur për shumë nxënësish me vajza e djem që qesh në mëngjes zbrisnin sokakët e lagjeve për të hyrë në klasat e kësaj shkolle që është simbol i arsimit tonë kombëtar.

Këto ditë ndodhem në Gjirokastrë takova rastësisht Nestor Zhupin, dialin e mësuesit të ndjerë të gjimnazit të Gjirokastrës, Jani Zhupi. Isha me kolegun dhe mikun tim mësuesin me identitet të këtij gjimnazi Muhamet Sinanin, së bashku me muzikologun dhe mikun tonë Kosta Loli po mblidhnim impresione e kujtime nga Shkolla e Muzikës, për të sistemuar kujtime me mësuesin e matematikës Nestor Zhupi. Gjatë bisedës me Muhametin dhe Nestorin mësova më gjerësisht për punën pasionante të mësuesit Jani Zhupi ndonëse edhe unë dija diçka nga jeta e tij në dekadat e punës në Gjirokastrë. Kur flasim për mësuesit e gjimnazit të Gjirokastrës si simbol i kësaj shkolle dhe arsimit tonë, përmendim me respekt e mirënjohje Basho Thoma Papaqano "Mësues i Popullit", "Nder i Kombit". Mes dhjetëra e qindra mësuesve të kësaj shkolle ka qenë edhe mësuesi Jani.

BIOGRAFIA E TIJ :

Ndonëse kam qenë nxënës në këtë gjimnaz e ndoqa si mangësi që s'pata fatin të kem mësues ndonjërin nga

bangja e kësaj shkolle. Por janm krenar që studioja për muzikë në Liceun Artistik "Jordan Misja" në Tiranë, shkolla kombëtare që për 80 vjet përgatiti artistë e të ardhmes.

Por le të ndalemi më gjerësisht në kontributin modest të këtij mësuesi në fushën e arsimit dhe më gjerë. Jani Zhupi ka lindur në vitin 1919 në fshatin Dhuyjan të Dropullit të Poshtëm në krahinën e minoritetit grek në Shqipëri. Mësimet e para të fillores i mori në fshatin e lindjes ndërsa 7-vjeçarën e vazhdoi në fshatin Sofratikë po në Dropullin e Poshtëm. Në vitin 1943 Jani pas përfundimit të 7-vjeçares u inkudra në formacionet partizane që vepronin në zonat e minoritetit të rrethit të Gjirokastrës. Pas mbarimit të luftës duke pasur dëshirë për t'u shkolluar shkoi në Elbasan për të studiuar në "Normalen" e qytetit si shkolla që përgatitiste mësuesit e të ardhmes nga të gjitha rrethet e vendit.

Dëshira për dije dhe kulturë bëri që Jani Zhupi të shkonte më tej për të studiuar në Tiranë në Fakultetin Biologji-Kimi, studime që i përfundoi me rezultate të larta.

Në përfundim të studimeve me diplomën e mësuesit ai kthehet në Gjirokastrë dhe emërohet mësues i lëndës "biologji-kimi" në gjimnazin "Asim Zeneli" Gjirokastrë. Në këtë mënyrë i bukur i mësuesit pasionant ku për dekada do të vazhdonte mësimi i këtij mësuesi të dashur për nxënësit dhe së bashku me gjithë kolektivin e mrekullueshëm të mësuesisë të kësaj shkolle do ta vendosnin atë në Panteonin e Arsimit Shqiptar.

Përgatitja e nivelit shkencor për shpjegimin e mësimin, punët pasionante në laboratorinë e shkollës, puna e



diferencuar me nxënësit më pak aktivë do të ishte motoja e punës së Janit.

Duke parë rezultatet e punës së tij si mësues gjimnazi, ai emërohet Inspektor i Seksionit të Arsimit në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë. Gjatë viteve të detyrës së mësuesit ka pasur një plejadë mësuesish më përgatitje më të thellë metodiko-shkencore duke i dhënë këtij rrethi një vlerësim të lartë në rang rrethi. Me tej karriera e tij vazhdon në detyrën e nderuar Drejtor i Shkollës së Ndërtimitarisë në qytetin e Gjirokastrës, ku puna e tij si veterani i mësuesisë prodhon vlera të çmuara, çka i pasqyruan në rezultatet e larta dhe përgatitjen e nxënësve në degët e ndryshme të shkollës si mekanik-elektricitist në përfundim të shkollës të pajisjes me njohuri teknike dhe të punonin në sektorë të ndryshëm.

Stacioni i fundit i mësuesit pasionant ishte Universiteti "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë, duke vazhduar misionin e tij si pishtar i dritës në de-

tyrën fisnike si misionar i arsimit në vendin tonë.

U ula të shkruaj lçetë vlerësim për mësuesin pasionant Jani Zhupi në vazhdim të shkrimeve për personazhe të ndryshme të qytetit tim të dashur që me modesti kanë kontribuar me bujari në përparimin e këtij rajoni, vlerë në trashëgiminë tonë që vjen nga largësia e shekujve deri në ditët tona. Për ta rujtur, pasuruar dhe trashëguar këtë vlerë në brezat pasardhës na takon ne gjirokastritëve të sotëm së bashku me trevat përreth, ta çojmë më përpara këtë vlerë dhe trashëgimi si pjesë e identitetit tonë kombëtar duke e pasuruar me vlera të reja.

Le të jemi modestë dhe dashamirës e mirënjohës duke i vlerësuar këta personalitete të arsimit të Gjirokastrës me mirënjohje nga Bashkia, Qarku e Prefektura duke i memorizuar në kujtesën popullore si simbole e vlera ku duhet t'i referohemi për ta trashëguar këtë trashëgimi.

IN MEMORIAM

Një zë i fuqishëm krijues në letrat dhe kulturën shqipe

VILHELME VRANARI HAXHIRAJ, MISIONARE E DIJES DHE ATDHETARIZMIT

Avdyl Buçpapaj*

Në historinë e kulturës shqiptare ka personalitete që nuk maten vetem me numrin e veprave që lënë pas, por me forcën e mendimit dhe të shembullit të tyre njerëzor, me personalitetin intelektual dhe me gjurmën shpirtërore që vënë dhe lënë në kujtesën e bashkëkohësve, pse jo edhe të brezave që vijnë.

Një prej këtyre figurave ishte shkrimtarja Vilhelme Vranari Haxhiraj, e njohur në botën letrare me emrin artistik, "Vivra", një krijuese që e jetoi letërsinë si mision, si akt ndërgjegjeje dhe si formë e lartë shërbimi ndaj së vërtetës dhe identitetit kombëtar.

Sot, kur ajo është larguar nga kjo botë dhe na shikon nga yjet, kujtimi i saj shfaqet jo vetem si një ndjenjë mallëngjimi për njeriun e respektuar, por edhe si një detyrim moral për të dëshmuar mbi vlerat e një personaliteti, e cila arriti të ndërtojë një profil të veçantë në peizazhin kulturor të Shqipërisë së tranzicionit demokratik. Kjo është arsyeja që kjo shkrimtare të vlerësohet këtu në mëmëdhe, madje e dhe në botë, me tituj e çmime nderi. Vilhelme Vranari Haxhiraj përfaqëson te atë kategori intelektualësh që nuk u formësuan nga privilegjet e kohës, por nga përballja me vështirësitë, nga rezistenca ndaj padrejtësisë dhe nga besimi i palëkundur tek liria e mendimit dhe dinjteti njerëzor.

E quaj veten me fat që kam pasur mundësinë ta njoh nga afër, gjatë një veprimtarie kulturore, historike dhe letrare të organizuar në Nëntor të vitit 2012, në shkollën "Demokracia", në Durrës, të cilën në atë periudhë e drejtoja unë. (Takimet vazhduan edhe në veprimtari të tjera në vite të mëvonshme).

Ka kohë që jam shkëputur nga ajo shkollë, por veprimtaritë e zhvilluara në ato vite më ngacmojnë shpirtërisht, pasi jo vetëm kanë lënë gjurmë te i gjithë kolektivi mësitor por edhe te nxënësit. Ishin dhe mbeten ngjarje të papërsëritshme, jo vetëm për kohën.

Shkolla "Demokracia" në qytetin e Durrësit, në vitin 2007, krijoi lidhje, apo "Binjakëzim" me shkollën "Fjardiskolan", në Boras të Suedisë. Shkëmbyem vizita të ndërsjellta. Ne pritëm drejtues e mesues suedezë, shkrimtarë dhe administrator të jetës shtetërore në Suedi, së bashku me mesues, prindër e nxënës shqiptarë me banim në Suedi. Po ashtu edhe ata na pritën bujarisht, drejtues mesues dhe nxënës shkolle, punonjës e drejtues të Bibliotekës Publike të Durrësit. Po zgjatëm më tej, ata po ashtu pritën dhe përcplën edhe shkrimtarë, gazetarë e pedagogë, nga Tirana. E gjitha e përmbledhur me dy fjalë të "Gazetarit" tonë Kadri Tarelli, koleg mesues e drejtues shkolle, i cili të dy shkollat i quante: - "Dy ambasada". Njëra në Durrës dhe tjetra në Boras, sepse veprimtaritë i kalonin fuqitë



dhe miundësitë e një shkolle 9-vjeçare. Mjafton të kujtoj: Takime në Bashkinë e Durrësit, në Drejtorinë Arsimore, në QKF, në Bibliotekën Publike të qytetit, më tej, takim në Ministrinë e Arsimit në Tiranë, Radio Tirana, vizita në Prishtinë, Mitrovicë, Tropojë, Lezhë, etj, etj, lista bëhet e gjatë. Po mjaftohem të përmend vetëm disa nga shkollat e qytetit, ku janë bërë takime: Shkolla "14 Nëntori", "Neim Babameto" (Spitallë), shkolla jo publike: "Turgut Ozal" Shkozë, "Kasa" Plazh, "Iliria", Plazh. Ndërkohë që takimet u shtrinë edhe në disa shkolla të Tiranës.

Është një faqe e ndritur për shkollën dhe kolektivin arsimor, që organizoi dhe përjetoi ato takime të rralla. Besoj dhe jam i bindur që nuk gabo, se nuk ka shkollë tjetër në Shqipëri, mbase edhe përtej gardhit tonë, që të ketë bërë kaq shumë takime dhe biseda të rangut shtetëror, sa edhe ambasadat do t'i kishin zili. Më vjen mirë që janë shkruar shumë artikuj në shtyp, (Atëherë ishte gjallë edhe Gazeta "Mësuesi"), por më vjen keq që nuk janë përmbledhur në një libër. Kujtimet, vjen një ditë veniten, rroniten dhe humbasin.....!

Ishte pikërisht kjo njohje dhe ky shkëmbim veprimtarish, që bëri të mundur festimin e përbashkët të "100-vjetorit të Mëvetësisë", Nëntor 2012, në mjediset e shkollës "Demokracia", me shqiptarë nga Durrësi, Tirana, Vlora dhe nga Dardania shqiptare.

"Rastësia mbreti i jetës", - thot i mençuri popull. Ishte pikërisht kjo veprimtari, ku kolektivi i shkollës, në bashkëpunim me Klubin e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Durrësit, u bëmë bashkë, krijues, studiues, letrarë, poetë dhe artistë nga qytete të ndryshme shqiptare. Nga Durrësi: Nkolla Spathari, kryetar i Klubit të shkrimtarëve, poeti Vaso Papaj, Agim Bajrami, Vladimir Muça. Nga Tirana shkrimtari i njohur Viron Kona, Prof. Dr. Murat Gecaj, miq nga Vlora dhe nga Prishtina, si edhe autorë, letrarë, studiues e poetë shqiptarë, që jetonin dhe krijonin në Suedi, miq të hershëm të shkollës "Demokracia".

Në atë takim ishte e pranishme edhe

shkrimtarja vlonjate Vilhelme Vrana Haxhiraj, bashkë me të shoqin Fitim Haxhiraj. Ishin pikërisht miqtë tanë, shkrimtarët Sokol Demaku dhe Hamit Gurguri, shqiptarë nga Drenica e Dardanisë, që jetonin dhe punonin në Suedi, njëkohësisht edhe si anëtarë të "Lidhjes Mbretërore të Shkrimtarëve dhe Artistëve" të Suedisë", që sollën për poeten tonë Vivra, çmimin e I-rë, si fituese, me të cilin ishte vlerësuar në festivalin poetik të zhvilluar pak kohë më parë, në Boras të Suedisë. Më vjen mirë që kam në bibliotekën personale, një libër me dedikim nga Zonja e madhe Vilhelme Vranari, "Princesha e Kaninës", siç i thërrasim tani.

Në atë mjedis kuvendi historik dhe reflektimi kombëtar, prania e Vilhelme Vranari Haxhiraj u shqua menjëherë për seriozitetin intelektual, për kulturën e gjerë enciklopedike dhe për aftësinë e saj të admirueshme për të ndërthurur mendimin historik me vizionin letrar. Ajo prezantoi veprën e saj kushtuar themeluesit të shtetit shqiptar, Ismail Qemalit, "E djeshmja, rikthimi i Ismail Qemalit", një libër që mishëronte interesin e saj të vazhdueshëm për figurat kyçe të historisë kombëtare dhe për raportin midis kujtesës historike dhe vetëdijes qytetare.

Diskutimi i zhvilluar me nxënësit, mesuesit dhe pjesëmarrësit e tjerë i tejkaloi kufijtë e një përurimi të zakonshëm letrar. Ai u shndërrua në një tribunë mendimi, ku autorja trajtoi çështje që lidhen me rolin e letërsisë në formësimin e identitetit kombëtar, me përgjegjësinë morale të intelektualit në shoqëri dhe me sfidat e demokracisë shqiptare në procesin e saj të konsolidimit. Fjala e saj ishte e qartë, e argumentuar dhe e mbështetur mbi një përvojë të pasur jetësore dhe kulturore, duke dëshmuar një formim të gjerë humanist dhe një ndjeshmëri të spikatur qytetare.

Ajo që më ka mbetur më fort në kujtesë është fisnikëria e natyrshme që e karakterizonte. Vilhelmja ishte një grua e kulturës së lartë, e pajisur me një urtësi të fituar jo vetëm nga librat, por edhe nga përvoja e një jete të përballur me sprova të shumta. E

goditur nga mekanizmat përjashtues të diktaturës komuniste dhe e ndaluar për dekada nga e drejta e botimit, ajo nuk pranoi kurrë kompromisin me ndërgjegjen e saj. Përkundrazi, ruajti me krenari integritetin moral dhe besimin tek vlerat që e udhëhiqnin. Në këtë këndvështrim, jetëshkrimi i saj përfaqëson një shembull dhe dëshmi të fuqishme të qëndrësës intelektuale shqiptare, përballë sundimit ideologjik. Një model për t'u marrë shmbull frymëzimi nga të rinjtë e çdo kohe.

Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit e shkollës sonë, ajo u dallua për aftësinë e rrallë për të komunikuar me brezin e ri. Çdo fjalë dhe përgjigje e saj ishte e mbushur me kulturë, argument dhe elegancë mendimi. Në personalitetin e saj bashkëjetonin natyrshëm shkrimtarja, intelektualja, mësuesja, edukatorja dhe qytetarja aktive. Pikërisht kjo harmoni e virtyeteve, e bënte figurën e saj veçanërisht të respektuar dhe të dashur, për t'u kujtuar në përjetësi, siç po bëj edhe unë në këtë shkrim të shkurtër. Në shikim të përgjithshëm, mendoj se vlera dhe pesha krijuese letrare e Vilhelme Vranarit Haxhiraj nuk kufizohet vetëm në kontributin e saj letrar e studimor. Ajo përfaqëson një model të intelektualit që i mbetet besnik së vërtetës, që nuk e shikoi letërsinë si stoli estetike, por si mjet të emancipimit shoqëror dhe të vetëdijes kombëtare.

Vetëm pas shembjes së regjimit komunist, talenti dhe energjia e saj krijuese gjetën hapësirën e merituar për t'u shprehur. Rezultati ishte i dukshëm: Në veprën dhe jetën e saj gjejmë ndërthurjen e rrallë të talentit krijues me karakterin e pathyeshëm, me shkallën e lartë të dijes, lidhur me shkencën dhe qytetarinë, të kujtesës historike me vizion humanist e atdhetar.

Prandaj, kujtimi për Vilhelme Vranari Haxhirajn mbetet përtej nostalgjisë personale. Gjithçka është kujtim për një grua që u përball me kohën, për një krijuese që e fitoi me meritë vendin në letërsinë bashkëkohore shqiptare. Njëkohësisht për një personalitet që do të vazhdojë të jetojë nëpërmjet veprës së vet, si pjesë e trashëgimisë sonë kulturore dhe shpirtërore.

Figura e saj meriton jo vetëm nderimin e miqve dhe bashkëkohësve, por edhe vëmendjen serioze të strukturave drejtuese shtetërore lokale e qendrore, të kritikës letrare dhe të historiografisë, filozofisë e kulturës shqiptare, sepse ajo ishte një nga ato zëra që e pasuruan dhe pasqyruan letërsinë dhe historinë tonë me besnikëri, me dinjtet dhe me përkushtim të rrallë krijues.

Ajo ishte dhe mbeti "Misionare e dijes dhe atdhetarizmit".

***Ish-drejtor i shkollës "Demokracia", Durrës -Fotografia nga Kadri Tarelli**

RECENSA

Lexojen librin e tij të porsa botuar “Pa titull” dhe ia vini vetë titullin


ARTI I TË SHKRUARIT NË KRITIKAT LETRARE TË SHPENDI TOPOLLAJ

FATMIR MINGULI

Në një librin tim kushtuar veprës shumëdimensionale të poetit, prozatorit, eseistit, publicistit, dramaturgut dhe kritikut letrar Shpendi Topollaj, e kam quajtur atë: “Një shkrimtar i çuditshëm”. E kam quajtur të tillë, jo vetëm se profesioni i tij ka qenë oficer e më pas, jurist, jo vetëm për nivelin e lartë të veprave të tij, as se për të dhe veprën e tij janë shkruar gjashtë libra voluminozë, por se duke e nisur rrugën e botimeve me vonesë, pas moshës 45 vjeçare, pra, pas ardhjes së demokracisë, ai pa asnjë dyshim, me 83 librat e tij, mund të konsiderohet ashtu sikurse e kanë quajtur me të drejtë, si më prodhimtari në fushën e letrave tona. Dhe çudia më e madhe qëndron te fakti, që edhe pse asnjëherë nuk ka pranuar promovimin e librave të tij, ai lexon pa reshtur krijimtarinë e autorëve të tjerë, shkruan rreth tyre, organizon paraqitjen te lexuesit dhe analizat që bën, i boton sa në gazeta, aq edhe në librat e tij. Ndaj dhe shkrimtari i mirënjohur Xhevat Mustafa, duke u bazuar te thellësia e gjykimit, erudicioni dhe sidomos dashamirësia e tij, që mirëfilli është krijimtari në kuptimin që i jepte Ciceroni kësaj gjinie kur arsyetonte se “Unë kritikoj duke krijuar, jo duke gjetur gabime”,



ka thënë se është fat për atë shkrimtar, veprën e të cilit e analizon Shpendi Topollaj. Dhe ja ku vjen ai, pas botimit të “Kadareja i pavdekshëm” (për të cilin Helena i shkruante se sa do të doja sikur ta kishte lexuar vetë Ismaili), me librin e ri të titulluar “Pa titull”, botimi Shtëpisë Botuese 2M, ku janë përfshirë shkrimet e tij, kushtuar veprës së shkrimtares së mirënjohur Mira Meksi “Ikona e Plagosur”, romanit të Ani



Wilms “Dielli në mërgim”, librit të Profesor Irakli Koçollari “Lufta e Ftohtë”, monografisë “Musine Kokalari një Yllësi” të Uran Butkës, romanit “Gabor” të Prof. dr. Fatmir Terziut, “Shkrepje të rralla fotografike” të Qerim Vrionit, poezisë së Jaho Margjekës, jetës së dr. Lame Koçit nga Eva S. Ceca, romanit të Hysen Qendros, studimit historik të Josif Ristos për Tempullin e Dodonës, veprës së Ali Balliut, Hasan Shahinajt,

• *Kultura jonë letrare ka nevojë për analiza letrare si këto të autorit të çuditshëm e dashamirës Shpendi Topollaj, i cili në çdo sallë ku ligjëron e në çdo artikull që boton, teksa vlerëson veprat e shkrimtarëve tanë, krijon atë atmosferën që përmend Uajllidi*

Mjeshtrit të Madh Halil Rama, përkthyesit Gëzim Baruti, koleksionistit Hysen Dizdari, e deri piktorëve Arben Kristani e Muhamet Malilaj etj. Duke lexuar të 45 librat vetëm me kritika letrare të Shpendit, nuk ka sesi të mos kujtosh se qysh te libri i tij i parë “Flakët e Fjalës”, i ndjeri Gjergj Zheji vinte në dukje se kemi të bëjmë me një lloj të ri kritike. Dhe i tillë ka mbetur ai në analizat e pafund kritike që bën, gjë për të cilën akademiku Kopi Kyçyku shkruante: “Nga pikëpamja e formës kemi të bëjmë me artikuj kritikë, por mënyra si shtjellohen e zërthehen temat, na jepet mundësia të gjendemi përpara essesh të mirëfillta, që kanë doza të forta, - gjithnjë në masën e duhur, - filozofike e psikologjike”. Nga ana e tij, kundërshtri viktorian i çdo lloj dogme dhe mediokriteti, Oskar Uajllid (Oscar Wilde), kishte mendimin se “është kritika ajo që krijon atmosferën intelektuale të një epoke”.

E përmenda këtë, për të thënë se kultura jonë letrare ka nevojë për analiza letrare si këto të autorit të çuditshëm e dashamirës Shpendi Topollaj, i cili në çdo sallë ku ligjëron e në çdo artikull që boton, teksa vlerëson veprat e shkrimtarëve tanë, krijon atë atmosferën që përmend Uajllidi. Prandaj, edhe shkrimtari shkodoran Sadedin Limani e ka quajtur atë “Njeri Kometë”. Sepse pikërisht si një kometë që përhap dritë në skutat e errëta të universit, Shpendi përhap dijen... Ai si një kometë e vërtetë përpin librat e shkruar e të studiuar prej kush e di sa krijuesve, hulumtuesve kontributor për vendin e tyre në tërë viset shqiptare e më gjerë dhe përcjell me bishtin e saj ndriçues analizën e tij të hollë sintetike... me pathos e dashuri e mirënjohje për secilin. Një pozitivist i pasqor që e nxjerr fjalën e mirë edhe prej fundit të dheut”. Nuk kam çfarë të shtoj tjetër, veçse t’u them: lexojen librin e tij të porsa botuar “Pa titull” dhe ia vini vetë titullin.

VLERAT SHËRUESE TË RAZMËS

Vijon nga faja 12

vetëm ne, por as banorët e Razmës.” Doktor Tonin Trashnaj, mjek turni në kampin e pushimit të punëtorëve, kujton: “Për herë të parë në Razëm kam qenë në verën e vitit 1971 dhe më pas, vite me radhë, kam shërbyer si mjek në kampin e punëtorëve. Ruaj kujtime shumë të bukura. Jeta në kamp ka qenë mirë e organizuar. Në klimin trembëdhjetëditor të qëndrimit, kampistët merrnin shëndet e energji dhe nga Razma merrnin kujtimet më të mira e më të bukura. Kam vijuar të shkoj në Razëm gjatë stinës së verës. Më është bërë zakon. Këtu i njoh dhe më njohin pothuajse të gjithë. Kam shumë lidhje miqësore me banorët vendas, që janë fisnikë, shumë të dashur dhe me shumë humor. Ditët këtu kalojnë shpejt, ndihem i relaksuar, marr shëndet dhe energji për gjithë vitin. Gjithmonë, edhe në ditët tona, janë të shumtë individët dhe familjarët që dalin rregullisht në Razëm; një pjesë e tyre i njoh edhe personalisht. Ata kanë pasur probleme me frymëmarrjen dhe, falë efektit shërues të këtij vendi, janë përmirësuar. Më vjen keq që Razma nuk promovohet për vlerat e jashtëzakonshme shëruese që ka, as në vendin tonë të vogël”. Mjaft domethënës është edhe skica letrare “I vetum në majë”, e shkrimtarit të mirënjohur koso-

var Ag Apolloni, Razëm, prill 2023. Nga ky shkrim kam shkëputur këto radhë: “Pesëmbëdhjetë ditë më parë erdha në Razëm për shkak të një problemi serioz me mushkëritë si pasojë e COVID-19. Kam qenë në disa spitale në Kosovë e Maqedoni, por shëndeti kishte marrë 4 tatëpjetë dhe nuk ekzistonte ndonjë mrekulli shkencore që ta ndryshonte drejtimin. Kur erdha këtu, tri ditët e para arrita të ec vetëm gjysmë ore, pastaj një orë, dy orë, dhe në fund të javës e ndjeva ndryshimin, kurse në ditën e dymbëdhjetë nisa vrapimin. ... Po jua them këtë, meqë të gjithë kemi kaluar pandeminë. Sugjerohani Razmën të gjithë atyre që kanë probleme me mushkëritë. Meqë “medicus curat, natura sanat” (“mjeku kuron, natyra shëron”) ... një falënderim i veçantë shkon natyrisht për Razmën.” Sipas Inteligjencës artificiale, klima e Razmës konsiderohet gjerësisht si një nga më të mirat në Ballkan për trajtimin e sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes. Pse vlerësohet Razma për mushkëritë? Lartësia dhe ajri i pastër: ndodhet rreth 900 m mbi nivelin e detit dhe ofron ajër të pasur me oksigjen dhe pa ndotje urbane; gërshe-timi i klimave: kombinim i ajrit malor me rryma të buta detare; pyjet me pisha: lëshojnë substanca natyrore me efekt antimikrobik; afërsia me detin: ndikon në cilësinë e ajrit dhe jonizimin e tij; flora

e pasur: kontribuon në pastërtinë dhe freskinë e ajrit. *** Nga këto shkrime vërtetohen vlerat shëruese të Razmës, që gjatë njëqind e katërmëdhjetë viteve të shtetit shqiptarë janë lënë jashtë vëmendjes. Razma është një pasuri shumë e rëndësishme kombëtare që duhet të promovohet jo vetëm në vendin tonë, por edhe në Europë duke bërë të njohura vlerat e saj shëruese. Duhet që të gjithë së bashku, të mos kursejmë përpjekjet tona, që të arrijmë, që të sëmurët evropianë, që kanë probleme me mushkëritë të vijnë në Razëm. Kur ata të njihen me mrekullitë e shumta që natyra i ka dhuruar këtij fshati të vogël alpin; kur ata ta provojnë vetë vlerat shëruese të këtij vendi, jam i sigurtë se do të jenë ata vetë, që do të bëjnë të njohur ndërkombe-tarisht Razmën. Me angazhimin e shtetit, zhvillimi i këtij stacioni shërues do të jetë i jashtëzakonshëm, i shpejtë dhe i gjithanëshëm.


Me përparësinë që shteti shqiptar po i jep zhvillimit të turizmit malor, dhe me “Paketën e Maleve” që aplikimi i saj këtu zë vend më shumë se kudo tjetër, unë kam besim se kjo kohë për Razmën, është kohë historike. Gjithmonë me ndihmën e Zotit.

Leopold Loro Shkreli Shkodër,
Maj 2026

NDERIMI

Dhjetra personalitete akademike dhe të letrave vlerësojnë librin e ish - drejtuesit të institucioneve kryesore kulturore të Ushtrisë Shqiptare

TATJANA PARLLAKU: KOLONEL BESHIR CALA I ORIENTUAR DREJT VLERAVE EUROATLANTIKE



Vijon nga faqja 9

Nikolla - Mjeshtëri i Madh, jo vetëm në profesionin e tij por mbi të gjitha si njeri, edhe në moderimin e këtij event i përçolli me mjeshtëri të rrallë artistike emocione, duke ngritur peshë zemrat e qindra pjesëmarrësve nga kryeqyteti dhe jo vetëm, por edhe nga Dibra, Durrësi, Lezha e Shkodra. Dhe jo vetëm me moderimin, por edhe me interpretimin e poezive të librit "Guri i shkukur" të poetit Beshir Cala, si: "Unë dhe qyqja", "Trishtim", "Kananarina", "Një jetë do pres", "Në thellësi të tokës", "Mysafiri" etj, duke përcjellë për qindra pjesëmarrësit në promovim mesazhet e fuqishme të poezive të këtij autori.

Edhe aktori Arben Mevlani interpretoi me ndjenjë disa poezi të librit "Guri i shkukur", por ajo që befasoi të pranishmit në këtë event qe mbesa e autorit të librit, Ola Cala, studente për informatikë, me recitimin me mjeshtëri artistike të poezisë "Guri i shkukur", nga ka marrë titullin ky libër.

"Të dashur pjesëmarrës! Më lejoni t'ju shpreh mirënjohjen time të sinqertë për praninë tuaj në promovimin e këtij libri, të shkruar nga gjyshi im, Beshiri. Përtej këtij statusi, ai ishte për mua një mendje e ndritur, pranë së cilës gjeja gjithmonë mbështetje dhe frymëzim. Ai ishte mësuesi im i parë, këshilltari im më i besuar dhe, mbi të gjitha, miku im më i mirë...Për mua, është një nder i veçantë të jem sot para jush për të recituar poezinë 'Guri i Shkukur', e cila mban titullin e vetë librit dhe përfaqëson frymën, mesazhin dhe thelbin e kësaj vepre", u shpreh Ola, e impresionuar por me një zë brilant para se të fillonte recitimin e poezisë.

Të larmishëm e bënë këtë veprimtari promovuese, me performacën e tyre artistike, edhe këngëtarët e njohur Bledar Kaca e Xhevair Marku dhe Muharrem Elezi, me interpretimin e këngëve "Jam krenar që jam dibran" dhe "Bashkimi Kombëtar". Ndërkohë edhe Radiotelevizioni Publik Shqiptar (RTSH) transmetoi një kronikë speciale nga kjo veprimtari promovuese.

